



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 19/2021 regjistër (JR)  
Datë 19.04.2021

Nr. 26 i vendimit  
Datë 06.07.2022

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 06.07.2022, ditën e mërkurë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI I ANKIMIT:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 342, datë 02.02.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, me funksionin gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana

Lluri, e cila kërkoi lënien në fuqi të tij, dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, ushtronte detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex-officio*.
2. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të neneve 33, 34 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
  - 2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar<sup>1</sup>, duke konstatuar se: i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
  - 2.2 DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës<sup>2</sup>, duke konstatuar, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.
  - 2.3 KLGj-ja, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, i ka përcjellë Komisionit një raport<sup>3</sup> të hollësishëm për vlerësimin e aftësive profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 342, datë 02.02.2021, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura lidhur me kriteret e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat ka konkluduar se:
  - 3.1 **Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:** [...] subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj. Trupi gjykues çmon se mungesa

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2018.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 01.03.2019, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.12.2019.

e likuiditeteve gjatë vitit 2012 në vlerën – 691.723 lekë dhe gjatë vitit 2016 në vlerën – 209.181 lekë, në një vlerë totale prej – 900.904 lekësh për gjithë periudhën e deklarimit si rezultat financiar negativ pas analizës financiare të përditësuar, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit.

Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, (i) përgjegjësia për të provuar rrethanat dhe ligjshmërinë e marrjes së kredisë me kushte lehtësuese marrë nga z. G. H., (ii) përgjegjësia për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për pasurinë e luajtshme, automjet në përdorim të z. G. H. nga babai i tij, janë rrethana që lidhen drejtpërdrejtë me të si subjekt rivlerësimi në procesin administrativ të kryer ndaj tij nga një tjetër trup gjykues.

[...] faktet e referuara më sipër në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i rivlerësimit znj. Elbana Lluri, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

**3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:** [...] Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë, edhe pas kryerjes se hetimit të thelluar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

**3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:** [...] Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH” i ndryshuar, Komisioni, pasi ka analizuar raportin e përgatitur nga KLGj-ja, hetimit dhe vlerësimit të denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### III. Shkaqet e ankimit

4. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, pasi ka administruar rekomandimin për ankim të hartuar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 342, datë 02.02.2021, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri.
5. Komisioneri Publik, në ankim, ka parashtruar se, nëpërmjet këtij mjeti procedural, në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, në mbrojtje të interesit publik e në mbështetje të rekomandimit të vëzhguesve ndërkombëtarë, synon kontrollin e vendimit nr. 342, datë 02.02.2021, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe interesat privatë të tij, të personave të lidhur, të personave të tjerë të lidhur me të, si dhe kryerjen e një analize të re financiare, me qëllim justifikimin bindshëm të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive me të ardhura të ligjshme, sipas urdhërimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
6. Gjithashtu, Komisioneri Publik, në ankim, ka parashtruar se, në vijimësi të qëndrimeve të mbajtura nga ky institucion në ushtrimin e ankimeve, nëpërmjet të cilave kërkohet hetimi i mëtejshëm i kriterëve të rivlerësimit, referuar përmbajtjes së pikës 2 të nenit 4, pikës 1 të nenit 59 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, çmon se për të arritur eventualisht në një vendimmarrje për

konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit, edhe kontrolli i dy kritereve të tjera të procesit të rivlerësimit, ai profesional dhe i figurës, bazuar në nenin E dhe nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, duhet t'i nënshtrohet hetimit dhe vlerësimit nga ana e Kolegjit.

7. Referuar përmbajtjes së ankimit të Komisionerit Publik, rezulton se çështjet e ngritura adresohen vetëm në drejtim të kontrollit të pasurisë, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**7.1 Për pasurinë nr. 1, apartament me sip. 125 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë,** Komisioneri Publik ngre pretendimin se mbetet e paqartë analiza financiare mbi mundësinë e personit të lidhur për krijimin me burime të ligjshme të shumës 1.500.000 lekë, të deklaruara nga subjekti si kursime personale të bashkëshortit ndër vite, të përdorura për kryerjen e pagesës së pjesshme të kësaj pasurie në vitin 2011. Në drejtim të këtyre të ardhurave, Komisioneri Publik pretendon se analiza financiare e kryer nga Komisioni është e paqartë dhe duhet ribërë prej Kolegjit, mbështetur në pretendimet e ngritura në ankim.

**7.2 Për kredinë e marrë në shumën 25.000 euro nga Emporiki Bank,** për të cilën subjekti ka deklaruar se ka shërbyer për rikonstruksionin dhe mobilimin e pasurisë nr. 1 apartament me sip. 125 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, Komisioneri Publik kërkon prej Kolegjit të ushtrohet kontroll mbi destinacionin e kredisë dhe në drejtim të verifikimit të mundësisë financiare të personave të tjerë të lidhur për dhënien e huas në vlerën prej 25.000 eurosh, e cila ka shërbyer për shlyerjen e saj.

**7.3 Për pasurinë nr. 2, apartament, me sip. 126 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Vlorë, të blerë në vitin 2016<sup>4</sup>** nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në vlerën 55.452 euro, Komisioneri Publik kërkon prej Kolegjit kryerjen e një analize të re financiare, për të mundësuar verifikimin dhe justifikimin në mënyrë bindëse të çdo burimi të ligjshëm që duket se është përdorur për krijimin e pasurive në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur).

**7.4 Në drejtim të analizës financiare, për diferencat negative në vitet 2012 dhe 2016,** Komisioneri Publik pretendon se përfundimi i arritur nga Komisioni për reduktimin e shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit të subjektit dhe personit të lidhur me të, duhet rivlerësuar nga Kolegji sipas pretendimeve të ngritura në ankim.

**7.5 Lidhur me automjetin “Audi Q7”,** për të cilin, nga subjekti i rivlerësimit, nuk është deklaruar përdorimi i tij në deklaratën *vetting*, edhe pse personi i lidhur ka pasur të drejta përdorimi me afat të papërcaktuar<sup>5</sup>, Komisioneri Publik pretendon se konstatimet e Komisionit, referuar automjetit të përdorur nga familja<sup>6</sup> e subjektit të rivlerësimit, nuk janë të plota, pasi duhen verifikuar të drejtat e ushtruara nga ana e subjektit të rivlerësimit mbi këtë automjet, nisur nga

---

<sup>4</sup> Me kontratë shitblerjeje me nr. {\*\*\*} rep, e nr. kol.{\*\*\*}, e datës 17.9.2016.

<sup>5</sup> Sipas kontratës noteriale të huapërdorjes të datës 7.07.2011 me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., të personit të lidhur të lidhur me babanë e tij.

<sup>6</sup> Në përgjigje të pyetësorit standard në datën 16.10.2017, subjekti i rivlerësimit E.Lluri ka deklaruar se ka pasur në përdorim së bashku me bashkëshortin z. G. H. automjetin e babait të tij z. R. H., tip “AUDI”, me targa {\*\*\*}. Në fashikull disponohet kontrata noteriale e huapërdorjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., e datës 07.07.2011, e lidhur ndërmjet babait të personit të lidhur R. H. dhe G. H. mbi përdorimin e automjetit tip “Audi Q. 7”.

situata faktike dhe juridike, si element përcaktues për nevojën e përlogaritjes së mundësisë financiare në fitimin e pronësisë.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

9. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 342, datë 02.02.2021, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.

Përgjatë seancave gjyqësore, Komisioneri Publik, në mbështetje të ankimit të tij, ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke kërkuar nga Kolegji kryerjen e hetimeve të mëtejshme, rezultatet e të cilave mbështetën kërkimin përfundimtar të tij për një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni të këtij kriteri.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka prapësuar pretendimet e Komisionerit Publik duke analizuar në mbështetje të këtyre prapësimeve, provat e paraqitura prej saj përgjatë hetimit administrativ, si edhe ato të administruara prej Kolegjit përgjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

10.1 Me qëllim shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 342, datë 02.02.2021, të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të marrë në seancën gjyqësore të datës 28.03.2022, vendosi të kryejë një analizë financiare paraprake<sup>7</sup>, duke iu referuar kërtimeve të ankimit të Komisionerit Publik. Kjo analizë paraprake e hartuar nga Kolegji në mbështetje e duke reflektuar në terma financiarë kërkimet e paraqitura në ankimin e

---

<sup>7</sup> Kryerja e kësaj analize financiare nga Kolegji, u vlerësua e nevojshme, referuar ankimit të Komisionerit Publik, i cili ka kërkuar: “[...] Nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 342, datë 2.02.2021, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe interesat privatë të tij, personave të lidhur, personave të tjerë të lidhur me të, si dhe kryerjen e një analize të re financiare, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive, me të ardhura të ligjshme, sipas urdhërimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016”.

Komisionerit Publik, iu përcoll për njohje e mbrojtje subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, e cila, në seancën gjyqësore të datës 09.06.2022, paraqiti prapësimet dhe provat mbi të cilat ajo mbështeti pretendimin se kjo analizë është e pasaktë dhe e padrejtë.

11. Në përgjigje të kërtimeve të Komisionerit Publik, kërkit të subjektit të rivlerësimit dhe nevojave të veta për hetime të mëtejshme lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30, 32, 33 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji, me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues, çeli hetimin gjyqësor duke marrë në cilësinë e provës, për nevoja të hetimit gjyqësor, aktet e paraqitura në Kolegj nga vetë subjekti i rivlerësimit.
12. Vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, me shkresën me nr. reference {\*\*\*}, datë 26.04.2022, të emërtuar “Opinion”, referuar përcaktimeve të nenit 49, paragrafi 11 i ligjit nr. 84/2016, paraqiti para trupit gjykues një mendim me shkrim, tek i cili evidentoi nevojën që Kolegji të shqyrtojë mundësinë e bashkimit të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri dhe të subjektit të rivlerësimit, z. G. H., ky i fundit ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, njëkohësisht edhe vetë subjekt rivlerësimi, ose në alternativë, të administrojë me cilësinë e provës reciprokisht aktet e secilit procedim te njëri-tjetri.

12.1 Në seancën gjyqësore të datës 04.05.2022, Komisioneri Publik deklaroi se e konsideron në tagër të gjykatës vlerësimin e opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar. Në të njëjtën seancë, edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, paraqiti qëndrimin e saj lidhur me opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar, duke shpjeguar se në parim nuk ka asnjë shqetësim/kundërshtim lidhur me faktin nëse Kolegji do të pranojë të bashkojë ose jo procesin e saj të rivlerësimit me atë të ish-bashkëshortit. Subjekti në këtë qëndrim deklaroi se Kolegji, në funksion të kësaj vendimmarrjeje, duhet të konsiderojë disa pengesa procedurale që ekzistojnë, të cilat në kuptim të neneve 23 e 24 të ligjit nr. 49/2012, si dhe të neneve 57, 158 dhe 448 të Kodit të Procedurës Civile pengojnë bashkimin e çështjeve në këtë fazë të gjykimit.

12.2 Kolegji, pasi u njoh edhe me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me opinionin e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar, me vendim të ndërmjetëm, mbështetur në përcaktimet e neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi marrjen në cilësinë e provës të akteve që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, që i përkasin procesit të rivlerësimit në Komision dhe në Kolegj, të subjektit të rivlerësimit G. H., duke i dhënë këtij të fundit, si dhe Komisionerit Publik të drejtën të njihen me to. Kolegji vlerësoi se opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar që sugjeronte bashkimin e procedimeve, u gjend pa ndikim në vendimmarrje, për shkak të konsiderimit në parim të proceseve të rivlerësimit të secilit subjekt, si procese autonome dhe të pavarura nga njëri-tjetri, pavarësisht koneksitetit në kriterin e vlerësimit të pasurisë në rastin konkret. Administrimi i të gjitha akteve që lidhen me këtë kriter, të rezultuara nga hetimi për personin e lidhur, u vlerësua nga Kolegji se plotëson dhe i përgjigjet proporcionalisht nevojës së pasjes dijeni për çdo të dhënë lidhur me këtë kriter, duke mundësuar trupën gjykuese në marrjen e një vendimi me një bazë sa më të gjerë informacioni rreth situatës faktike.

13. Në Kolegj, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, janë administruar denoncime që i adresoheshin subjektit të rivlerësimit, të depozituara nga denoncuesit A. H.<sup>8</sup>, M. M.<sup>9</sup>, J. H.<sup>10</sup>, V.

---

<sup>8</sup> Administruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 08.11.2021.

<sup>9</sup> Administruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021.

<sup>10</sup> Administruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 16.04.2021.

T.<sup>11</sup>, P. M.<sup>12</sup> dhe A. D., si përfaqësues i “{\*\*\*}” ShA, Tiranë<sup>13</sup>. Të gjitha këto denoncime, Kolegji ia vuri paraprakisht në dispozicion subjektit të rivlerësimit, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Lidhur me këto denoncime, në seancën gjyqësore të datës 28.03.2022, subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, konfirmoi marrjen e tyre dhe paraqiti shpjegimet/parashtrimet e saj lidhur to, si dhe kërkoi nga Kolegji të administrojë në cilësinë e provës aktet e sjella prej saj në funksion të këtyre parashtrimeve.

14. Kolegji, pasi u njoh me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, lidhur me denoncimet e administruara për të në Kolegj, analizoi dhe shqyrtoi shpjegimet e dhëna prej saj dhe provat e paraqitura në mbështetje të këtyre shpjegimeve, e konsideroi të plotë fazën e verifikimit të denoncimeve dhe vlerësoi se informacioni i përcjellë nëpërmjet tyre, nuk plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016, e nuk krijoi bindjen për shkeljet ligjore të pretenduara se janë kryer nga subjekti, për pasojë vendosi të mos i konsiderojë ato si me peshë në marrjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes.
15. Në përfundim të hetimit gjyqësor, Kolegji vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisionerit Publik, duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjenden në fashikullin e hetimit të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve.

## ***B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji***

### ***i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë:***

Kolegji mori në shqyrtim dhe ia nënshtrroi analizës së tij shkaqet e ankimit mbi të cilat u mbështet Komisioneri Publik në përfundim të procesit gjyqësor, si arsye për të cilat duhej të vendosej ndryshimi i vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi. Për pasojë, Kolegji konsideroi se Komisioneri Publik hoqi dorë nga shkaqet e ankimit të cilat lidheshin me pasurinë apartament prej 125 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, blerë në vitin 2011, në vlerën prej 6.500.000 lekësh, verifikimin e mundësisë financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, për t'i dhënë asaj huan prej 25.000 eurosh, që ka shërbyer për shlyerjen e kredisë bankare të marrë në vitin 2009 në Emporiki Bank, si edhe ato që lidheshin me të drejtat e subjektit të rivlerësimit mbi automjetin tip “Audi Q7” në pronësi të babait të ish-bashkëshortit të saj.

16.1 Kolegji vlerëson se Komisioneri Publik, i cili është titullar i së drejtës për të parashtruar ankim mbështetur në shkaqet që e përbëjnë atë, në përfundim të hetimit gjyqësor e pasi analizoi provat e paraqitura, ka vlerësuar se këto shkaqe të prezantuara si të tilla në ankim në mungesën e një hetimit të plotë, morën zgjidhje nga hetimi gjyqësor dhe u konsideruan se nuk përbëjnë një argument/arsye për cenimin e vendimit të Komisionit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se këto pretendime nuk duhet të jenë pjesë e vlerësimit të trupit gjykues, për sa kohë që kërkimi i Komisionerit Publik për ndryshimin e vendimit nuk mbështet në to, por në shkaqet e tjera të ankimit.

16.2 Në këto rrethana, në arsyetimin në vijim, Kolegji do të analizojë dhe shqyrtojë ato shkaqe ankimi, të cilat mbetën në vlerësimin e Komisionerit Publik si arsye mbi të cilat i kërkohet gjykatës ndryshimi i vendimit. Pjesë të këtij arsyetimi do të jenë edhe elemente të veçanta të analizës që

---

<sup>11</sup> Administruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.05.2021.

<sup>12</sup> Administruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.03.2022.

<sup>13</sup> Administruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2022.

interferonin në disa shkaqe të tjera ankimi, por të analizuar në funksion të dhënies përgjigje të pretendimeve të cilat u konfirmuan si të tilla në konkluzionet përfundimtare, pasi u zhvillua hetimi i plotë gjyqësor.

17. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e Komisionerit Publik të parashtruar në ankim dhe të konfirmuar si të tillë edhe në konkluzione përfundimtare se: *Lidhur me pasurinë apartament, me sipërfaqe 126 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Vlorë, blerë në vitin 2016<sup>14</sup>, me vlerën 55.452 euro, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të ish-bashkëshortit, të financuar me të ardhurat nga kursimet e tyre ndër vite, pas vlerësimit të të gjitha prapësimeve të subjektit e provave të paraqitura, rezulton se subjekti dhe ish-bashkëshorti gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për financimin e kësaj pasurie në vlerën prej (-) 5.432.452 lekësh, duke u mbështetur në argumentet si vijon:*

- (i) *Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting dhe në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë të vitit 2004, referuar gjendjes së cash-it në masën 5.000.000 lekë, për shumën e përfuturuar nga motra në shumën 35.000 lekë/muaj për periudhën 1997-2004 dhe për sa i përket dhurimit të shumës prej 2.000.000 lekësh, rezultojnë të mbështeten në deklarime kontradiktore dhe të paprovuara që nuk mundësojnë kontrollin e vërtetësisë së tyre,*
- (ii) *Analiza e deklarimeve për kursimet në cash të subjektit e personit të lidhur për vitet 2006-2012, tregon për vlera të këtyre kursimeve të ndryshme nga ato që pretendon subjekti për llogari të saj e personit të lidhur, duke ulur vlerën e provuar të kursimeve të mundshme e të provuara si të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e shumës për blerjen e apartamentit.*
- (iii) *Mosllogaritja si kursim e shumës prej 1.200.000 lekësh të ardhura prej shitjes së automjetit në vitin 2011 prej personit të lidhur, së bashku me rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2016, sipas deklarimeve të subjektit dhe metodologjisë së aplikuar nga Kolegji, afektojnë analizën financiare për kontrollin e burimeve të krijimit të pasurisë apartament në Vlorë, por edhe të gjithë analizës financiare të vitit 2016, duke ndikuar së bashku me shkaqet e tjera, në konkluzionin për balancën negative të cituar më lart.*

17.1 Lidhur me këtë pasuri, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është konkluduar se:

*[...] Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, vlerëson se bazuar në këto rrethana fakti dhe ligji, lidhur me të ardhurat e përfuturuar nga motra e saj, në shumën 35.000 lekë/muaj për periudhën 1997 – 2004, duke mbajtur në konsideratë se: (i) deklaratimet e subjektit në DPV-në e vitit 2004; (ii) mundësinë financiare të dhuruesve për të krijuar të ardhurat e dhuruara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore; (iii) këto të ardhura janë deklaruar nga subjekti para se të emërohej në detyrë, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë përfitim dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.*

*Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2012, në vlerën (-) 691.723 lekë dhe gjatë vitit 2016, në vlerën -209.181 lekë, në një vlerë totale prej -900.904 lekësh për gjithë periudhën e deklarimit, si rezultat final financiar negativ pas analizës financiare të përditësuar, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit.*

*Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrin kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, (i) përgjegjësia për të provuar rrethanat dhe ligjshmërinë e marrjes së kredisë me kushte lehtësuese marrë nga z. G. H., (ii) përgjegjësia për të provuar*

<sup>14</sup> Me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., e nr. kol. {\*\*\*}, e datës 17.9.2016.



*ligjshmërinë e gjendjes cash para fillimit të detyrës nga z. G. H., dhe (iii) përgjegjësia për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për pasurinë e luajtshme, automjet në përdorim të z. G. H. nga babai i tij, janë rrethana që lidhen drejtpërdrejt me të si subjekt rivlerësimi në procesin administrativ të kryer ndaj tij nga një tjetër trup gjykues.*

17.2 Nga analiza e akteve të administruara përgjatë procesit të rivlerësimit, rezulton se kjo pasuri është deklaruar se është blerë prej subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj në vitin 2016, duke identifikuar si burim të krijimit të tij, kursimet e përbashkëta në vite të krijuara prej të dy bashkëshortëve. Rezulton gjithashtu se ish-bashkëshortët nuk kanë zotëruar kursime në likuiditet pranë sistemit bankar, përveç atyre të deklaruara se janë zotëruar prej tyre në gjendje *cash* në banesë, duke filluar që prej viteve 2003 e 2004 e deri në krijimin e kësaj pasurie. Në këto rrethana, në këndvështrim të shkaqeve të ankimit të ngritura prej Komisionerit Publik, të cilat në thelb kanë kërkuar nga Kolegji, analizimin dhe vlerësimin e vërtetësisë së deklarimeve lidhur me këto likuiditete, por edhe verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e tyre, Kolegji shqyrtoi në funksion të kontrollit të këtij shkaku, vërtetësinë e deklarimeve të subjektit e personit të lidhur, si edhe verifikoi mundësinë e tyre për të krijuar me burime të ligjshme shumën e pretenduar, prej 55.546 eurosh, që shërbeu më pas si burim për financimin e kësaj pasurie.

17.3 Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit, së bashku me ish-bashkëshortin i nënshtrohen detyrimit për justifikimin e këtij burimi të deklaruar se ka shërbyer për të dy ata nën regjimin e bashkësisë ligjore, për krijimin e një pasurie të përbashkët në kuptim të neneve 73 e vijues të Kodit të Familjes. Ky detyrim buron nga përcaktimi i nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, përcaktim i cili ka udhëhequr në çdo rast jurisprudencën e Kolegjit në të njëjtën optikë<sup>15</sup>.

17.4 Rezulton se për këtë pasuri, në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore (në vijim “DPV”) të vitit 2016, për apartamentin në Vlorë, subjekti ka deklaruar:  
*Apartament banimi me sip. 126,5 m<sup>2</sup>, nr. pasurie {\*\*\*}, zona kadastrale nr. {\*\*\*}, në Vlorë, tërësisht i mobiluar dhe i gatshëm për shfrytëzim. Apartamenti është në bashkëpronësi me bashkëshortin G. H. dhe është blerë nga A. Ç. dhe A. Ç. Shuma për blerjen e apartamentit është siguruar nga kursimet e mia dhe të bashkëshortit tim, realizuar gjatë gjithë jetës sonë sipas përshkrimit të bërë në deklaratat tona të pasurisë për efekt të ligjit nr. 84/2016.*

17.5 Në drejtim të identifikimit të kursimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, të cilat kanë shërbyer për financimin e apartamentit, rezulton se ato janë deklaruar nga subjekti që në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2004 e në vijim dhe për personin e lidhur, që në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003 e në vijim.

17.6 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-2004 si gjendje *cash* të kursyer, vlerën prej 5.000.000 lekësh, si të holla “*cash*” të ruajtura në shtëpi, me burim, kursim nga të ardhurat e mia e familjes, dhuratë nga motra. Në vitet në vijim, subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë në deklaratat periodike të pasurive, shumë e konsideruara prej saj si kursime në *cash*, të cilat kanë shërbyer në vite për të financuar disa shpenzime për subjektin dhe familjen e saj, por edhe si një vlerë që i është shtuar vlerës prej

---

<sup>15</sup> Shih vendimin nr. 22/2019 (JR) që i përket subjektit i rivlerësimit Bujar Hoti; vendimin nr. 9/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Faqolli; vendimin nr. 14/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati; vendimin nr. 19/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori; vendimin nr. 27/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Malaj; vendimin nr. 24/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi; vendimin nr. 23/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Praela; vendimin nr. 15/2021 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita; vendimin nr. 11/2022 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

5.000.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën fillestare, për të krijuar fondin e përbashkët bashkë me ish-bashkëshortin, për financimin e pasurisë apartament në Vlorë.

**17.7** Personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, se ka disponuar shumën 2.500.000 lekë, si gjendje *cash* në banesë, të krijuar me burim: *të ardhura të realizuara nga paga mujore gjatë 3 viteve si student në Shkollën e Magjistraturës, Tiranë, për periudhën 2000-2003; të ardhura të realizuara në sektorin privat gjatë periudhës shtator 1995 deri në janar 2000*. Personi i lidhur ka deklaruar gjithashtu në vitet në vijim, te rubrika e ndryshimeve të pasurisë kursime të krijuara prej të ardhurave të tij. Këto kursime, sipas deklarimeve të tij, kanë shërbyer, një pjesë për përballimin e disa shpenzimeve gjatë jetesës, dhe pjesa tjetër si një vlerë që u është bashkuar kursimeve të krijuara prej subjektit të rivlerësimit para martesës. Ky fond kursimesh i është bashkuar, sipas deklarimeve, kursimeve të përbashkëta të ish-bashkëshortëve, të krijuara pas martesës, për të konkluduar në shumën që ka shërbyer për financimin e pasurisë apartament të blerë në Vlorë.

**18.** Për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të Komisionerit Publik, në analizë të të gjitha fakteve që rezultuan nga hetimi dhe në këndvështrim edhe të prapësimeve e kundërshtimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, në gjykim, por edhe shpjegimeve të vazhdueshme që ajo ka dhënë gjatë hetimit administrativ në Komision, duke vlerësuar edhe qëndrimin dhe shpjegimet që ka dhënë personi i lidhur gjatë procesit të tij të rivlerësimit, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm që mori trupi gjykues për administrimin e të gjitha akteve të dosjes së tij, Kolegji çmon se çështjet që u shtruan për zgjidhje para tij, janë si më poshtë.

1. Kontrolli i vërtetësisë së deklarimeve të subjektit për disponimin e shumës prej 5.000.000 lekësh, si gjendje *cash* në banesë që në vitin 2004, verifikimin e burimeve të krijimit të kësaj shume dhe përcaktimin e vlerës që do të konsiderohet si ardhur e ligjshme në kuptim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, e vlefshme për t'u llogaritur si burim në krijimin e pasurisë objekt analize.
2. Kontrolli i vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, për gjendjen e pretenduar prej saj si kursim dhe të deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2006, 2007, 2008 e 2012, dhe përcaktimin e shumës që mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme për t'u përdorur si burim për krijimin e pasurisë objekt analize.
3. Kontrolli i vërtetësisë së deklarimeve të personit të lidhur për disponimin e shumës prej 2.500.000 lekësh *cash* në banesë, në vitin 2003, si edhe të kursimeve në *cash* të deklaruara prej tij në vitet 2006 - 2012, verifikimin e burimeve të krijimit të këtyre shumave dhe përcaktimin e vlerës që do të konsiderohet si e ardhur e ligjshme për t'u përdorur si burim për krijimin e pasurisë apartament objekt analize.
4. Rillogaritjen e zërit të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit për familjen e subjektit në vitin 2016.
5. Kryerjen e një analize financiare mbështetur në konkluzionet që do të rezultojnë pas analizimit të çështjeve të mësipërme, për të përlllogaritur mundësitë financiare të familjes së subjektit për justifikimin me burime të ligjshme të pasurisë objekt analize.

**18.1** Lidhur me çështjen e parë, Kolegji konstaton se krahas deklaramit të shumës prej 5.000.000 lekësh si gjendje në *cash* në deklaratën fillestare në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit e ka përshkruar këtë shumë te rubrika e të ardhurave edhe në deklaratën *vetting*, nën përgjegjësinë që përcakton neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, për të deklaruar me vërtetësi e plotësi të gjitha të ardhurat e krijuara, burimet e tyre dhe pasuritë e krijuara me to, me qëllim paraqitjen në optikën dhe përcaktimet e legjisllacionit të ri kushtetues të të gjithë informacionit të duhur e të nevojshëm për të bërë të mundur që organet e rivlerësimit të kryenin

një proces kontrolli objektiv dhe të vërtetë të pasurive në pronësi të subjekteve të rivlerësimit. Shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon në këtë kontekst edhe sanksion për mosplotësimin me saktësi e vërtetësi të kësaj deklarate<sup>16</sup>.

**18.2** Në këtë kuadër ligjor në fuqi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të detajuar në deklaratën *vetting*, burimet e krijimit të kësaj shume, duke përcaktuar si të tillë edhe të ardhurat nga *punësimi te biznesi i ndërtimit të motrës A. Ll. Ç. që nga viti IV i shkollës së mesme deri në vitin II të Shkollës së Magjistraturës (nuk kam pasur kontratë pune për shkak se isha e punësuar në një biznes familjar) me pagë mujore 30.000 - 40.000 lekë në muaj, plus të dhuruara nga motra ime, znj. A. Ll., për shkak të mbarimit shkëlqyer të Shkollës së Magjistraturës. Gjatë gjithë kësaj kohe, shpenzimet e mia përballoheshin nga të ardhurat nga bursa e shkollës si studente e shkëlqyer nga Fakulteti i Drejtësisë, prindërit me të cilët banonte dhe motra, znj. A. Ll.*

**18.3** Verifikimi i vërtetësisë të këtij deklarimi dhe provueshmëria e krijimit të këtyre të ardhurave të deklaruara se janë zotëruar *cash* që në deklaratën fillestare të pasurisë, ka qenë një detyrim i subjektit të rivlerësimit dhe, për këtë arsye, U është nënshtruar pyetjeve prej Komisionit përgjatë hetimit administrativ e juridiksionit kontrollues të Kolegjit, mbështetur në shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.

**18.4** Lidhur me shumën 2.000.000 lekë, deklaruar si dhuratë nga motra, subjekti kërkoi që të përfshihet si e ardhur në analizën financiare, duke pretenduar se për këtë vlerë, provohet ligjshmëria e krijimit të saj dhe mosdeklarimi i vlerës së dhurimit në deklaratën *vetting* ishte një lapsus, si dhe pretendoi se ky aspekt i analizës financiare nuk është ankimuar nga Komisioneri Publik. Komisioneri Publik sqaroi qëndrimet e kërkimet e tij në konkluzionet përfundimtare, duke e konsideruar këtë shumë si një pjesë të kursimeve të pretenduara se kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Vlorë dhe, për pasojë, duhet t'i nënshtrohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit.

**18.5** Kolegji, nga analizimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, si dhe i shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, për shumën 2.000.000 lekë të pretenduar si të dhuruar nga motra në vitin 2004, për mbarimin shkëlqyeshëm të Shkollës së Magjistraturës, konstaton se: **(i)** Në DPV-në fillestare të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurim nga motra, por shifra e dhurimit prej 2.000.000 lekësh nuk specifikohet. **(ii)** Edhe në deklaratën *vetting*, tek e cila sërish deklarohet dhurim i motrës në vitin 2004, nuk specifikohet shuma e dhuruar. **(iii)** Në dokumentin e administruar nga Komisioni, të marrë prej ILDKPKI-së, rezulton se në aktin e llojit procesverbal, të mbajtur në ILDKPKI, të emërtuar “Sqarime mbi deklarimin e pasurisë nga G. H. dhe E.Ll.”, të datës 20.01.2015, subjekti ka deklaruar se ka përfituar dhurim nga motra për shkak të mbarimit shkëlqyer të Shkollës së Magjistraturës, por edhe në këtë rast nuk ka evidentuar vlerën e shumës së dhuruar. **(iv)** Kolegji vëren se vetëm gjatë hetimit administrativ, me shpjegimet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka saktësuar se vlera e dhuruar prej motrës është në shumën 2.000.000 lekë dhe se ky dhurim është bërë pa dokument noterial. Gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk rezulton që subjekti të ketë sjellë dokumentacion provues (*si p.sh. ndonjë mandatpagese apo transfertë bankare të kohës*), me anë të së cilës të provohet dhurimi i shumës 2.000.000 lekë në vitin 2004. **(v)** Nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ, rezulton se, për të provuar përfitimin e shumës 2.000.000 lekë në vitin 2004, subjekti ka paraqitur si provë deklaratën noteriale të motrës A. Ç. (Ll.) dhe të bashkëshortit të saj A. Ç., me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.6.2018, në të cilën ata kanë deklaruar, ndër të tjera se: [...] për shkak

<sup>16</sup> Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

*të mbarimit me rezultate të shkëlqyera të Shkollës së Magjistraturës, si dhe për të ndihmuar daljen e saj në jetë, ne, z. A. Ç. dhe znj. A. Ll. (Ç.), i kemi dhuruar një sasi të ardhurash në shumën 2.000.000 lekë, pa kontratë, për shkak të marrëdhënies së posaçme që kemi mes nesh.*

**18.6** Nga analizimi i të dhënave të mësipërme, Kolegji konstatoi se, në përgjigje të këtyre pyetjeve të drejtuara nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit standard, dhe konkretisht asaj që lidhet me dhurimet e përfituara prej të tretëve, subjekti ndonëse ka dhënë përgjigje për shuma të dhuruara familjes me rastin e lindjes së fëmijëve, në vlera shumë më modeste se ajo e pretenduar si e dhuruar nga motra si studente e shkëlqyer, nuk ka deklaruar në të, vlerën e shumës së dhënë dhuratë e të përmendur në deklaratën *vetting*. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit edhe pse në shkelje të detyrimit ligjor për të deklaruar këtë shumë që në deklaratën *vetting*, aq më tepër që ajo kishte shërbyer si një burim i rëndësishëm për krijimin e pasurisë në vitin 2016, nuk e ka deklaruar atë as në përgjigjet e para të dërguara prej Komisionit. Duke vepruar në këtë mënyrë, subjekti nuk ka shfrytëzuar mundësinë që procesi hetimor i ka dhënë asaj për të shpjeguar në mënyrë shteruese çdo të dhënë me vlerë për procesin e rivlerësimit. Subjekti ka munguar në këtë mënyrë sërish, të përcaktojë vlerën e kësaj të ardhure, ndonëse ka pasur një kuptim të qartë për pyetjet që i janë shtruar, duke konsideruar përgjigjet e detajuara për dhurata e tjera.

Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit se vlera e kësaj të ardhure të dhuruar nga motra për shkak të përfundimit të studimeve me rezultate të shkëlqyera, është 2.000.000 lekë, e bërë prezente prej saj vetëm në pyetësin nr. 2 e në vazhdim të procesit, mbetet një e dhënë e cila nuk mund të verifikohet e që nuk krijon besueshmëri për ekzistencën e saj. Në këtë arsyetim, mbahet në konsideratë fakti se subjekti përfitonte në kohën e dhurimit të kësaj shume prej Shkollës së Magjistraturës, të ardhura në vlerën prej përafërsisht 29.326 lekësh në muaj, vlerë shumë modeste në raport me shumën prej 2.000.000 lekësh, të dhënë dhuratë nga motra. Kjo rrethanë logjikhshëm do të kërkonte vëmendje të shtuar e qartësi për vlerën e pasurisë së dhuruar, e cila ishte e pamundur të krijohej me të ardhurat personale të kohës, për pasojë pretendimi i subjektit se mospërcaktimi i saj është thjesht një “lapsus”, është i pabesueshëm për Kolegjin.

**18.7** Për shkak të kësaj situatë dhe të detyrimit që kishte subjekti i rivlerësimit të përcaktonte qartësisht të ardhurat që kishin shërbyer si burim për krijimin e pasurive, Kolegji vlerëson se subjekti kishte detyrimin ligjor të deklaronte vlerën e saj të paktën në deklaratën *vetting*, për sa kohë që ajo nuk gjendet e caktuar/deklaruar as në deklaratën fillestare të pasurisë. Përcaktimi i saj në një kohë të avancuar të procesit të rivlerësimit, kur kishin filluar të identifikoheshin problematikat me natyrë financiare për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, çmohet se është kryer jo vetëm për nevoja të evidentimit të sforcuar të vlerës së vërtetë të dhuruar, por kryesisht për nevoja të ndreqjes e azhurnimit të situatës financiare të subjektit. Në këtë arsyetim, mbahet në vëmendje edhe fakti se të vetmet burime që mund të japin informacion për gjendjen e likuiditeteve *cash*, janë deklaratimet e subjekteve të rivlerësimit në deklaratat e pasurive, aq më tepër kur burimet e krijimit të tyre mbështeten vetëm në deklarime dhe në asnjë akt shkresor që të provojë plotësisht, ekzistencën e tyre apo burimin e krijimit të tyre. Në këtë kontekst, deklaratimet duhet të jenë bindëse, të qarta, koherente e në harmoni me të dhënat e tjera, në mënyrë që të arrijnë nivelin e duhur të provueshmërisë së kësaj lloj pasurie.

**18.8** Në këtë kuptim, mosdeklarimi i vlerës së dhurimit në kohën e përcaktuar prej ligjit në DPV-në e vitit 2004 dhe as në deklaratën *vetting*, madje as në pyetësin e parë, e bën të pabesueshëm deklarin e subjektit, për dhurimin nga motra të shumës prej 2.000.000 lekësh. Deklarimi i vlerës së dhurimit, për më tepër, do të ishte i nevojshëm në rastin konkret, kur provohet se të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit kanë në një mënyrë ose një tjetër lidhje me dhurata apo trajtimet preferenciale të kryera prej motrës së subjektit të rivlerësimit.

Kjo paqartësi dhe paplotësi e përsëritur në deklarime dhe e pashoqëruar me akte shkresore provuese të kohës, por vetëm me deklarimet noteriale të motrës e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, për vlerën e të cilave Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar<sup>17</sup>, i vënë organet e rivlerësimit në vështirësi për të verifikuar vërtetësinë e tyre. Pretendimet e përsëritura të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe në Kolegji, se e motra gëzonte një situatë financiare shumë të mirë dhe kishte mundësi financimin jo vetëm të kësaj shume apo të privilegjeve të tjera, por edhe të vlerave shumë më të mëdha, nuk janë përgjigje ligjore dhe të bazuara në fakte në drejtim të qëllimit për të cilin është ngritur ky proces dhe adresimit që ai bën për kontrollin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit. Pavarësisht situatës financiare të motrës së subjektit të rivlerësimit, e cila, nën statusin e personit tjetër të lidhur, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka justifikuar shumat e dhuruara ndaj subjektit të rivlerësimit, Kolegji nënvizon faktin se subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, duke qenë një magjistrate e Republikës, ka pasur detyrim kushtetues dhe ligjor të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive të saj. Subjekti nuk mund të zhvishet nga ky detyrim kushtetues duke identifikuar burimet e krijimit të pasurive të saj me dhuratat, ndihmat apo mbështetjen financiare të familjarëve, qofshin këta edhe shumë të afërt, si një mënyrë jetese që nuk do të konsiderohej e përshtatshme për figurën e një magjistrati, në themel të së cilës qëndron pavarësia, duke filluar që nga ajo ekonomike.

**18.9** Për këtë çështje, Kolegji arriti në përfundimin se mbeti i paprovuar përfitimi nga subjekti i rivlerësimit, i shumës prej 2.000.000 lekësh, e deklaruar si vlerë e dhuruar prej motrës së subjektit, vetëm në përgjigjet e saj për pyetësonin nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, shumë e cila nuk gjendej e deklaruar as në deklaratën e pasurisë *vetting*, as në deklaratën fillestare të pasurisë dhe as në përgjigjet e dhëna nga subjekti për pyetësonin standard nr. 1 të Komisionit, në të cilin ka dhënë shpjegime të detajuara për dhurimet e përfituara prej motrës së saj, por sërish pa e deklaruar këtë shumë. Mosshpjegimi dhe mospërcaktimi i vlerës së kësaj të ardhure në këto deklarime, pamundësoi kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së përfitimit të saj, e cila ka shërbyer për të krijuar kursimet në *cash* të subjektit të rivlerësimit, në vlerën prej 5.000.000 lekësh.

- 19.** Lidhur me verifikimin dhe provueshmërinë e krijimit të shumës së përfituar prej punësimit të deklaruar te biznesi i motrës, sipas deklaratës *vetting*, në vlerën 35.000 lekë – 40.000 lekë/muaj për periudhën 1997-2004, nga aktet e administruara gjatë procesit, rezultuan faktet e mëposhtme.
- (i) Në *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për vitet 1997-2004, ka përfituar të ardhura nga punësimi në biznesin e ndërtimit të motrës A. Ç. (pa pasur kontratë pune, për shkak se ishte e punësuar në biznes familjar), me pagë mujore 30.000 – 40.000 lekë në muaj
  - (ii) Në *DPV*-në fillestare të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit nuk ka specifikuar se ka përfituar të ardhura nga punësimi në aktivitetin privat të motrës së saj.
  - (iii) Më datë 20.01.2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj janë thirrur në *ILDKPKI* për të dhënë shpjegime lidhur për ndryshimin e pasurisë. Nga procesverbali i mbajtur për të shpjeguar burimet e krijimit të shumës 5.000.000 lekë, si kursime në *cash* në *DPV*-në fillestare të vitit 2004, subjekti, si një prej burimeve të krijimit të kësaj shume, ka

---

<sup>17</sup> Shih vendimet e Kolegjit: nr. 6/2018(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Besa Nikëhasani; nr. 7/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku; nr. 34/2019(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti; nr. 2/2020(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani; nr. 23/2020(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prella; nr. 24/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi; nr. 29/2020(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi; nr. 33/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci; nr. 11/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri; nr. 12/2021(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Madani; nr. 11/2022(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

deklaruar: të ardhurat e përfituara nga punësimi në biznesin e ndërtimit të motrës A. Ç., nga viti IV i shkollës së mesme e deri në vitin II të Shkollës së Magjistraturës (pa pasur kontratë pune, për shkak se ishte e punësuar në biznes familjar), me pagë mujore 30.000 – 40.000 lekë në muaj.

- (iv) Gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë për të faktuar të ardhurën e marrë nga angazhimi te biznesi privat i motrës së saj, dy deklarata noteriale të lëshuara gjatë kohës së nisjes se procesit të rivlerësimit nga motra dhe bashkëshorti, me anë të të cilave ata deklarojnë:
- Në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.6.2018, deklaruesit A. dhe A. Ç. janë shprehur se Elbana Lluri, që prej vitit IV të shkollës së mesme deri në vitin II të shkollës së Magjistraturës, ka qenë e punësuar pranë biznesit tonë të ndërtimit dhe qiradhënies, me pagë mujore 35.000 lekë.
  - Ndërsa në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.12.2020, po të njëjtit deklarues, A. dhe A. Ç., kanë deklaruar se Elbana Lluri, gjatë periudhës 1997-2004, i është dhënë një shpërblim simbolik mujor, në masën 35.000 lekë, për ndihmën e ofruar për mbajtjen e fëmijëve dhe angazhimin në punët.
- (v) Vetë subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, në shpjegimet e dhëna për rezultatet paraprake të hetimit për periudhën 1997-2004, ka pretenduar se: [...] ka pasur ndihmë dhe kontribut nga motra A. Ç., me pagesa të përmuajshme prej 35.000 lekësh. Kjo ndihmë nuk ishte në formën e pagës mujore, sepse unë nuk punoja e nuk mund të isha e punësuar në atë periudhë, por për të mos u ndjerë unë keq e për të më shpërblyer në një farë mënyre lidhur me ndihmën që unë i jepja motrës sime në mbajtjen e fëmijëve (5 dhe 7 vjeç në atë kohë), në mbledhjen e qirave të pasurive të paluajtshme të tyre dhe për çdo nevojë e mundësi që unë kisha për t'i ndihmuar.

**19.1** Subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësime në Kolegj, deklaroi se natyra e marrëdhënies së saj me të ardhurat e përfituara prej motrës, të deklaruara si pagë në deklaratën *vetting* dhe si ndihmë në pyetësor e në vijim, ka qenë një marrëdhënie mes motrash, e cila ka justifikuar mbështetjen financiare të dhënë nga motra për shkak të gjendjes së saj financiare shumë të mirë, por edhe të afërsisë dhe veçantisë së marrëdhënies midis motrave.

**19.2** Kolegji konstaton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit vijnë në këtë mënyrë për shkak të mungesës së një akti shkresor të kohës, që provon si marrëdhënien e punësimit, ashtu edhe pagesën apo edhe shlyerjen e detyrimeve fiskale që vijnë për shkak të një marrëdhënieje të tillë. Në versionin e deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting*, nën përgjegjësitë që prodhon ky deklarim, konstatohet se kjo marrëdhënie përshkruhet si një marrëdhënie punësimi, e cila ka shërbyer për krijimin e një të ardhure për subjektin, në vlerën prej 3.360.000 lekësh<sup>18</sup>. Subjekti i rivlerësimit nuk solli asnjë dokument në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së kësaj marrëdhënieje apo edhe të ardhurave të krijuara prej saj, qoftë edhe në nivelin e indicieve, siç mund të ishin akte të prodhuara prej subjektit apo dokumente në të cilat kishte ndonjë gjurmë se subjekti kishte kryer realisht një detyrë në një pozicion konkret pranë biznesit të motrës për gjithë vitet e deklaruara prej saj në deklaratën *vetting*. Këto pretendime fillestare të subjektit mbetën krejtësisht në nivel deklarativ.

**19.3** Pretendimet e ndryshme të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit gjatë një faze të avancuar të hetimit administrativ, që përkon edhe me kohën pas mbajtjes së qëndrimeve të Kolegjit për provueshmërinë e marrëdhënieve të punësimit, dhe që përshkruajnë në një mënyrë tjetër llojin e

<sup>18</sup> Të ardhura të deklaruara nga subjekti në deklaratën “*vetting*”, për periudhën 1997-2004, nga punësimi te biznesi i ndërtimit të motrës A. Ç., me pagë mujore 35.000 lekë në muaj, në total për 23 muaj, arrin vlerën 3.360.000 lekë.

marrëdhënies që ka prodhuar si të ardhur shumë prej 3.360.000 lekësh, mbeten gjithashtu në nivel deklarativ dhe të pambështetura në asnjë provë, përveçse në deklarinimin e bashkëshortëve Ç. Këto deklarime kanë mangësi të theksuara në vlerën e tyre provuese si të gjitha deklaratat noteriale të krijuara gjatë procesit të rivlerësimit e të pambështetura nga të dhëna që vijnë nga burime të tjera, si dhe kanë edhe defektin e rëndësishëm në drejtim të besueshmërisë së tyre, për sa kohë ato vijnë në kundërshtim, së paku me deklarinimet që vetë këta individë kanë dhënë brenda të njëjtimit proces, për të njëjtën marrëdhënie. Deklarinimet se këto shuma ishin simbolike për subjektin e rivlerësimit e, për pasojë, nuk dukej se meritonin një interes të dedikuar drejt dokumentimit të tyre për efekt provueshmërie, konsiderohen prej Kolegjit si pa vend, për sa kohë këto shuma të përfituara sipas deklarinimit të subjektit, tejkalonin ndjeshëm edhe pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në kohën e përfitimit të tyre dhe, për më tepër, kanë shërbyer për krijimin e një shume prej 5.000.000 lekësh gjendje *cash* në banesë, e cila nuk mund të nënvleftësohej për kohën e krijimit, madje edhe sot, kur pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë rritur në mënyrë të ndjeshme.

**19.4** Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se në krijimin e kësaj shume, kanë shërbyer edhe të ardhurat e prindërve, dhurimet që motra u ka bërë prindërve periodikisht ndër vite, të cilat duhet të kalkuloheshin prej Kolegjit në zërin e analizës “të ardhura”, llogaritje e cila, sipas subjektit, do të ndryshonte balancën e analizës financiare që kontrollonte krijimin e kësaj pasurie, duke prezantuar për vlerësim dy versione të analizës financiare që Kolegji do të duhej të konsideronte. Konstatohet se ky pretendim nuk gjen pasqyrim në deklaratën *vetting*, në të cilën subjekti ka përshkruar në mënyrë të detajuar se nga cilët komponentë përbëhej shuma prej 5.000.000 lekësh.

**19.5** Në përgjigje të këtij pretendimi, Kolegji çmon të nënvizojë qëndrimin se objekt i punës së organeve të rivlerësimit, është kontrolli i vërtetësisë së deklarinimeve të subjekteve të rivlerësimit të kryera në deklaratën *vetting* dhe verifikimi i burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurive. Procesi hetimor administrativ apo ai gjyqësor i zhvilluar prej organeve të rivlerësimit, nuk mund të jetë një proces që fton/lejon subjektet të bëjnë deklarime të reja, më të volitshme për vlerësimin e pasurisë së tyre. Ata janë të ftuar të japin shpjegime e të paraqesin prova që mbështesin deklarinimet e tyre dhe jo të modifikojnë deklarinimet në përputhje me problematikat e prezantuara. Verifikimi i deklarinimeve është një proces *post factum* dhe, si i tillë, nuk mund të ndërtohet mbi deklarime të bëra rishtas, aq më tepër kur ato kundërshtojnë deklarinimet e bëra nën përgjegjësi të deklaratave *vetting*. Për më tepër, fakti që subjekti i rivlerësimit prezanton në mbrojtjen në seancë gjyqësore në Kolegj, dy versione që lidhen me situatën financiare të familjes së saj, të ndryshme në zërat që përcaktojnë të ardhurat e shpenzimet, vlerësohet nga Kolegji si një element që potencon mungesën e besueshmërisë të deklarinimet e subjektit, për sa kohë që ajo vetë nuk ka një të vërtetë të vetme jetësore për të mbrojtur, por e prezanton atë në versione alternative, në përputhje dhe në funksion të një rezultati pozitiv për të. Kolegji ka përlllogaritur në analizën financiare se të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe të motrës së saj kanë shërbyer për të përballuar shpenzimet e saj të jetesës, duke mos e ngarkuar subjektin me këto vlera<sup>19</sup> dhe ka konsideruar si të ardhura që kanë përberë shumë prej 5.000.000 lekësh të gjitha ato të ardhura që subjekti ka përshkruar në mënyrë të detajuar në deklaratën *vetting* dhe të cilat plotësojnë kriteret e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si edhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 për të ardhurat e ligjshme në kuptim të këtij procesi<sup>20</sup>.

<sup>19</sup> Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar se: “Gjatë kësaj kohe, të gjitha shpenzimet e mia përballoheshin nga të ardhurat nga bursa si studente e shkëlqyer nga Fakulteti i Drejtësisë, dhe nga prindërit me të cilët banonte, dhe motra e saj A. Ll. (Ç.)”.

<sup>20</sup> Në D-Vetting, subjekti detajon burimet e krijimit të kursimeve në *cash* në vitin 2004, të shumës 5.000.000 lekë, duke deklaruar se: “Shuma neto 5.000.000 lekë, e krijuar me këtë përshkrimin, si: Të ardhura neto të përfituara nga: (i)

**19.6** Në konkluzion, për të ardhurat e deklaruara prej subjektit në deklaratën *vetting*, si të përfituara në vitet 1997-2004 nga punësimi te biznesi i motrës, Kolegji, pasi analizoi burimet e krijimit të tyre sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, përveçse i gjeti ato kontradiktore me deklaratimet e mëpasshme të dhëna rreth këtyre burimeve gjatë procesit administrativ në Komision dhe shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, arriti në përfundimin se mbetën në nivel deklarativ e të paprovuara, si marrëdhënia e dekluar e punësimit të subjektit te biznesi i motrës së saj, ashtu edhe të ardhurat e krijuara nga kjo marrëdhënie në vitet 1997 - 2004, në vlerën prej 3.360.000 lekësh. Subjekti nuk pretendoi pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura gjatë procesit të rivlerësimit, për shkak të ndryshimit të kualifikimit të marrëdhënies nga “një marrëdhënie punësimi” në përcaktimin e saj si një “marrëdhënie ndihme familjare”. Për pasojë, mosprovueshmëria e marrëdhënies së punësimit dhe e të ardhurave të fituara prej saj, e shoqëruar edhe me mungesën e provueshmërisë të pagesës së detyrimeve tatimore për këto të ardhura, duke qenë se ato nuk u mbështetën me dokumentacion provues apo të dhëna nga burime të njohura sipas parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, u vlerësua nga Kolegji si një situatë që dëshmon për mosplotësimin e kriterëve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

**19.7** Për sa më sipër, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, dështoi të provonte përfitimin e këtyre shumave të deklaruara prej saj dhe totali i vlerës së llogaritur si e paprovuar, prej 3.360.000 lekësh, nuk u përfshi në analizën financiare të kryer për të verifikuar burimet e ligjshme të krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh në vitin 2004.

**19.8** Në përfundim të kësaj analize që lidhet me çështjen e parë të shtruar për zgjidhje, Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit arrinte të provonte mundësinë për të krijuar me të ardhura të ligjshme, vetëm shumën prej 1.265.447 lekësh, nga shuma e dekluar prej 5.000.000 lekësh, e cila iu konsiderua si e tillë edhe në analizën financiare të kryer për verifikimin e burimeve të krijimit të apartamentit në Vlorë dhe, për pasojë, duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën (-) 3.734.553 lekë.

- 20.** Lidhur me çështjen e dytë të shtruar për zgjidhje, Kolegji, në funksion të verifikimit dhe kontrollit të kursimeve në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë për vitet 2006, 2007 e 2008, për t'i dhënë përgjigje pretendimit të Komisionerit Publik mbi llogaritjen e saktë të tyre, mori në shqyrtim dhe analizoi këto deklarime në raport e harmoni me verifikimin e dokumenteve të administruara që provojnë të ardhurat e krijuara prej subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, përgjigjet e dhëna prej saj gjatë procesit hetimor e gjyqësor, si edhe në konsideratë të shpjegimeve e qëndrimeve që ka mbajtur edhe personi i lidhur për këto vlera monetare.

**20.1** Kolegji verifikoi deklaratimet e subjektit për kursimet në *cash* në vitet 2006, 2007 e 2008 dhe i analizoi ato vit pas viti, në raport me informacionin e përfutur prej dokumentacionit të administruar. Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, këto kursime janë krijuar prej të ardhurave të saj nga puna si gjyqtare dhe nga puna si pedagoge në Universitetin

---

*paga si studente e Shkollës së Magjistraturës (përfshi vitin III të stazhit si gjyqtare), e kursyer e gjitha; (ii) punësimi si pedagoge në Universitetin jopublik {\*\*\*} që nga themelimi i tij në vitin 2003 (pa kontratë deri në vitin 2004), me pagë mujore 25.000 lekë; (iii) punësimi te biznesi i ndërtimit të motrës sime A. Ll. (Ç.) që nga viti IV i shkollës së mesme deri në vitin II të Shkollës së Magjistraturës (nuk kam pasur kontratë pune, për shkak se isha e punësuar në një biznes familjar, me pagë mujore 30.000 lekë – 40.000 lekë/muaj); (iv) të ardhura të dhuruara nga motra A. Ll. (Ç.), për shkak të mbarimit shkëlqyeshëm të Shkollës së Magjistraturës.*



jopublik {\*\*\*}. Tipologjia e deklaramentit e cila ka prodhuar nevojën për analizë të *cash*-it në këto vite, lidhet me faktin se subjekti ka deklaruar si kursime në *cash*, vlera të njëjta me të ardhurat e krijuara prej punës si gjyqtare dhe pedagoge. Si edhe ka pretenduar se vlerat e krijuara prej shitjes dhe blerjes së dy automjeteve në njërin prej viteve të deklaramentit, duhet të konsiderohen si kursime në *cash* për atë vit.

**20.2** Analizës së Kolegjit lidhur me këtë çështje, përveç informacionit për pagat e subjektit iu nënshtrua edhe përmbajtja e shkresës së titulluar “Vërtetim”, e datës 26.10.2016, lëshuar nga Universiteti jopublik {\*\*\*}, në të cilën pasqyrohet se subjekti ka realizuar për periudhën tetor 2003 – dhjetor 2008, të ardhura neto nga puna si pedagoge në këtë universitet, në vlerën 774.360 lekë, pa specifikuar saktësisht vlerën e përfituar çdo vit. Gjithashtu, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.12.2019, Universiteti jopublik {\*\*\*} ka konfirmuar se: *Znj. Lluri është angazhuar si pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar {\*\*\*}, për periudhën tetor 2003 - dhjetor 2008. Për periudhën tetor 2003 - shtator 2004, institucioni nuk disponon dokumente. Të ardhurat e realizuara për periudhën tetor 2004 deri më dhjetor 2008, janë si më poshtë: të ardhurat bruto 860.760 lekë; tatim në burim 86.070 lekë; të ardhura neto 774.360 lekë.*

**20.3** Sipas Komisionit, në rezultatet e hetimit administrativ, meqenëse Universiteti jopublik {\*\*\*} nuk ka përcaktuar në mënyrë analitike të ardhurat për secilin vit, në analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat totale të ndara në mesatare aritmetike për të gjithë periudhën 2004 – 2007<sup>21</sup> (përfshijmë viti 2008, për të cilin shuma e të ardhurave i është kredituar subjektit në një shumë të caktuar).

**20.4** Meqenëse në vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 16.12.2019, të lëshuar nga Universiteti jopublik {\*\*\*}, pasqyrohet se të ardhurat e realizuara nga subjekti fillojnë në tetor 2004, dhe shtrihen deri në shkurt të vitit 2008, sipas deklaramentit të vetë subjektit në DPV-në e vitit 2008 dhe dokumentacionit bankar i cili konfirmon kreditimin e shumës prej 22.320 lekësh në këtë vit, Kolegji korrektoi shpërndarjen e këtyre të ardhurave në periudhën tetor 2004 - shkurt 2008, sipas analizës në vijim, duke konsideruar edhe periudhën akademike e cila mundëson çdo vit kalendarik përfitimin e të ardhurave për shkak të mësimdhënies.

**20.5** Nga totali i vlerës së përfituar neto, prej 774.360 lekësh, u zbrit shuma prej 22.320 lekësh, si pagesë e kryer nëpërmjet sistemit bankar në vitin 2008, duke dhënë vlerën prej 752.040 lekësh, si vlerë totale të përfituar prej subjektit në periudhën tetor 2004 deri dhjetor 2007. Kjo vlerë u pjesëtua me 30 muaj, numri i muajve brenda kësaj periudhe kalendarike<sup>22</sup>, dhe rezultoi një vlerë prej 25.068 lekësh në muaj, e cila u konsiderua si pagë mujore për subjektin në vitet e ekzistencës së kësaj marrëdhënieje. Mbi këtë metodologji, u vijua me përllogaritjen e të ardhurës së dokumentuar sipas shkresës së mësipërme, se sa ka përfituar subjekti nga kjo marrëdhënie, duke rezultuar se në vitin 2004, ka përfituar pagën për tre muaj, tetor-dhjetor, në vlerën 75.204 lekë, në vitin 2005, 2006 e 2007, pagën për 9 muaj në secilin vit, respektivisht në vlerën prej 225.612 lekësh dhe për vitin 2008 ka përfituar vlerën prej 22.320 lekësh, sipas vërtetimit bankar. Mbi këto përllogaritje, të cilat u kryen pas një analize logjike të shkresës së Universitetit {\*\*\*}, Kolegji vlerësoi edhe deklaramentet e subjektit për të ardhurat që janë deklaruar të përfituara prej kësaj marrëdhënieje e, për pasojë, edhe të *cash*-it të krijuar nga këto të ardhura. Në një vlerësim të përgjithshëm të kësaj analize, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në total në vite, të ardhura prej Universitetit {\*\*\*}, shumën prej 1.235.000 lekësh, e cila dukshëm është më e lartë

<sup>21</sup> Sipas Komisionit, vitet 2004, 2005, 2006, 2007 nga 188.078 lekë. Viti 2008 – 22.320 lekë.

<sup>22</sup> Viti 2004 - 3 muaj; viti 2005 - 9 muaj, viti 2006 - 9 muaj, viti 2007 - 9 muaj, total = 30 muaj.

se ajo që vërtetohet nga institucioni se është përfituar, duke bërë që në krye të herës të pabesueshme deklaratimet e subjektit për gjendjen *cash*, e cila është krijuar edhe për shkak të këtyre të ardhurave. Mbi këtë bazë, u analizuan deklaratimet e subjektit për gjendjen *cash* në këto vite, krahas përgjigjeve që ajo ka dhënë në pyetësonin nr. 2 të dërguar prej Komisionit gjatë hetimit administrativ, por edhe në konsideratë të shpjegimeve që ajo ka dhënë gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, të cilat, për faktin se në disa raste ndryshonin nga ato të mëparshmet apo tentonin të paraqisnin një situatë me alternativa llogaritjeje dhe krijuan kontrast me të dhënat e përftuara nga hetimi, nuk u çmuan sipas një vlere provuese bindëse. Në mbështetje të kësaj logjike, analiza e detajuar e këtyre deklaratimeve vijon si më poshtë.

**20.6** Në DPV-në e vitit 2006, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 450.000 lekë, të ardhura si pedagoge në Fakultetin {\*\*\*} në shumën 360.000 lekë, si dhe të ardhura nga shitja e automjetit në vlerën 400.000 lekë.* Në seksionin “Të ardhura nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar: “Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare në masën 900.000 lekë dhe të ardhura nga paga mujore si pedagoge në Fakultetin {\*\*\*} 45.000 lekë/muaj”. Në përgjigjet e pyetësonit nr. 2, subjekti ka deklaruar se *ka përfituar të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 972.560 (nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë dhe të ardhura si pedagoge në shumën 360.000 lekë. Po në këtë vit, si rezultat i shitjes së automjetit tip “Fiat Punto”, {\*\*\*}, dhe blerjes së automjetit tip “Opel Joy Corsa”, shpenzimeve të kryera për jetesë dhe shpenzimeve të tjera, kam kursyer shumën 800.000 lekë, e cila së bashku me shumën 100.000 lekë të kursyer në vitin 2005 dhe 5.000.000 lekë që ishte kursim i realizuar përpara fillimit të ushtrimit të detyrës, përbëjnë shtim të kursimeve të mia, në shumën totale 5.900.000 lekë*<sup>23</sup>.

**20.7** Kolegji vlerësoi se, pavarësisht se subjekti i rivlerësimi, znj. Elbana Lluri, i ka deklaruar si të ardhura dhe jo si kursime, në një lexim logjik të gjithë të dhënave, kursime të mundshme për këtë vit, referuar deklaratimeve të subjektit, mund të llogaritet vetëm shuma 450.000 lekë, kursime me burim nga paga, duke qenë se paga vjetore si gjyqtare është në vlerën 972.560 lekë, dhe vlera prej 225.612 lekësh si pedagoge në Universitetin jopublik {\*\*\*}. Kjo e fundit është maksimalisht shuma e përfituar prej saj nga kjo marrëdhënie sipas analizës së bërë më lart, në versionin që e gjithë e ardhura ka shërbyer për kursim dhe jo në vlerën e deklaruar prej saj, në shumën 360.000 lekë, e cila nuk provohet as që është përfituar në këtë vit, aq më pak të jetë krijuar si kursim në fund të vitit. Të ardhurat e krijuara apo të shpenzuara për shitblerje të pasurive automjete në këtë vit e të deklaruara në seksionin e ndryshimeve të pasurisë, nuk përfaqësojnë për Kolegjin vlera që duhet të llogariten si kursime, por vlera që pasqyrojnë ndryshimet në pasurinë e luajtshme të subjektit, të cilat kanë ndodhur gjatë vitit deklarues. Zëri kursime apo gjendje *cash* pasqyron një pasuri e cila nëse është krijuar në fund të vitit kalendarik, duhet të jetë përshkruar qartë si e tillë në deklaratën periodike, në mënyrë që të llogaritet në këtë status. Kolegji vlerëson se jo çdo e ardhur që deklarohet në këtë rubrikë gëzon statusin e gjendjes *cash*, aq më tepër kur ajo nuk

---

<sup>23</sup> Subjekti gjatë gjykimit në Kolegj, me prapësimet mbi analizën paraprake sipas pretendimeve të Komisionerit Publik, për kursimet e saj në “cash” për vitin 2007, ka shpjeguar se: “[...] Kjo do të thotë që në vitin 2006, kam realizuar të ardhura nga punësimi si gjyqtare dhe si pedagoge, gjithsej në shumën 1.055.300 lekë dhe kam kursyer shumën 810.000 lekë. Në vitin 2007, sipas së njëjtës logjike të sipërcituar, kam kursyer shumën 450.000 lekë nga të ardhurat e mia nga paga edhe si gjyqtare, edhe si pedagoge dhe në vitin 2007, kam realizuar kursim në shumën 225.000 lekë. Pra, në vitin 2006, kam kursyer vlerën 810.000 lekë dhe në vitin 2007, kam kursyer 450.000 lekë. Pavarësisht sa më sipër, nëse Kolegji nuk pranon arsyetimin e sipërcituar, mund të konsideroj shtimin e “cash-it” nga të ardhurat nga punësimi si pedagoge, të barabartë me vlerën e të ardhurave të dokumentuara sipas shkresës së Universitetit jopublik {\*\*\*}. Pra, në vitin 2006, gjendja “cash” të përllogaritet se është shtuar në vlerën 675.000 lekë, në vitin 2007 në vlerën 375.000 lekë dhe në vitin 2008 në vlerën 220.000 lekë”.

mbështetet as në dokumentacionin e administruar, përderisa subjektet nuk e kanë deklaruar si të tillë, sipas përcaktimeve ligjore të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003. Në finale, për vitin 2006, Kolegji përllogariti si kursim për subjektin, vlerën prej 675.612 lekësh.

**20.8** Në DPV-në e vitit 2007, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 150.000 lekë, të ardhura si pedagog në Fakultetin {\*\*\*} në shumën 300.000 lekë.*

Në seksionin “Të ardhura nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare në masën 825.442 lekë (795.442 pagë + 30.000 shpërblim) dhe të ardhura nga paga mujore si pedagoge në Fakultetin {\*\*\*} për periudhën janar – korrik 2007, në masën 45.000 lekë/muaj dhe për periudhën nëntor – dhjetor 15.000 lekë/muaj, dhe 3.000 lekë/orë mësimore.*

**20.9** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>24</sup>, të drejtuar nga Komisioni, për vitin 2007, subjekti nuk e ka pretenduar si kursim shumën e deklaruar si të ardhur nga puna si pedagoge në Universitetin jopublik {\*\*\*}, në vlerën prej 300.000 lekësh. Analiza e mësipërme vlen edhe në këtë rast, që sipas vlerësimit të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, nuk provohet të ketë përfiturar në këtë vit kalendarik prej Universitetit jopublik {\*\*\*}, shumën prej 300.000 lekësh, siç deklaroi, por vetëm shumën prej 225.612 lekësh, për pasojë deklarimi i saj për gjendjen e *cash*-it të krijuar në fund të vitit, përtej asaj që Komisioni i ka njohur, mbetet i paprovuar. Në këto kushte, Kolegji do të llogarisë si kursime të mundshme në fund të këtij viti, vetëm shumën prej 150.000 lekësh, të pranuar prej saj dhe të mos konsiderojë si të besueshme shpjegimet e saj kontradiktore, të prezantuara në disa variante për gjendjen e *cash*-it përgjatë procesit gjyqësor<sup>25</sup>.

**20.10** Në konkluzion, vetëm shuma e deklaruar si e ardhur nga paga prej 150.000 lekësh, mund të konsiderohet si shtesë *cash*-i për vitin 2007.

**20.11** Në DPV-në e vitit 2008, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 200.000 lekë (totali 819.775 lekë në vit), të ardhura si pedagoge në Fakultetin {\*\*\*} në shumën 25.000 lekë vetëm në muajt janar, shkurt.*

Në seksionin “Të ardhura nga angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtare në masën 200.000 lekë dhe të ardhura nga paga mujore si pedagoge në Fakultetin {\*\*\*}, për periudhën janar – korrik 2007, në masën 25.000 lekë vetëm për muajt janar, shkurt.*

Duke analizuar mënyrën e deklarimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, në këtë vit, konstatohet se vlera prej 200.000 lekësh, duhet të konsiderohet si kursim, pavarësisht deklarimit të saj si e ardhur, duke qenë se ajo është trajtuar si një pjesë e të ardhurave prej punës si gjyqtare. Ndërsa, nuk konsiderohet si kursim vlera prej 25.000 lekësh, e përfiturar prej Universitetit jopublik {\*\*\*}, duke qenë se në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti nuk e konsideron këtë vlerë si kursim të vitit, por vetëm si të ardhur.

---

<sup>24</sup> Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, për pyetjen 4 referuar të ardhurave të vitit 2007, subjekti ka shpjeguar sa vijon: *“Për vitin 2007, sipas deklaratës vjetore të këtij viti dorëzuar në ILDKP në dt. 19.03.2008, kam përfiturar të ardhura nga paga si gjyqtare në shumën 825.442 lekë dhe të ardhura nga paga si pedagoge në Fakultetin {\*\*\*} në shumën 300.000 lekë. Referuar shpenzimeve të kryera për këtë vit financiar dhe të ardhurave të përfituara, shuma e kursyer prej meje për vitin 2007, është shënuar në faqen 3 të formularit të vetëdeklarimit, në vlerën 150.000 lekë, shumë e cila i shtohet vlerës prej 5.900.000 lekësh, të kursyera në vitin 2004, 2005 dhe 2006, në një total kursimesh në shumën 6.050.000 lekë”.*

<sup>25</sup> Shih poshtëshënimin 23.

**20.12** Si konkluzion, shuma e kursyer në vitin 2008 dhe që do t'i nënshtrohet analizës financiare, është shuma prej 200.000 lekësh.

**20.13** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa në gjendjen *cash* për vitin 2009 dhe ka deklaruar shtesa në gjendjen e *cash*- it për vitet 2010 e 2011 në vlerat respektive prej 200.000 lekësh.

**20.14** Në DPV-në e vitit 2012, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Blerje e automjetit tip “Citroen C4”, me targa {\*\*\*}, me anë të kontratës Leasing. Shuma 9.679.47 euro e paguar, është siguruar në mënyrë të barabartë nga kursimet personale të subjektit dhe të bashkëshortit.* Në analizë të këtij deklarimi, Kolegji konsideroi se kursimet në *cash* të subjektit, të akumuluar përgjatë të gjitha viteve, deri në vitin 2012, ishin pakësuar me ½ e vlerës prej 9.679,47 eurosh, ekuivalente me (-) 676.208 lekë. Në këto kushte, nga shumatorja e kursimeve të konsideruara se janë deklaruar e janë provuar me burime të ligjshme deri në këtë kohë prej subjektit të rivlerësimit, Kolegji zbriti shumën e shpenzuar për blerjen e automjetit “Citroen C4”, duke shëruar në këtë mënyrë balancën negative të familjes për vitin 2012, sipas pretendimit të Komisionerit Publik në ankim, por duke zvogëluar njëkohësisht vlerën e kursimeve *cash*, të krijuara prej subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, më vete, deri në lidhjen e martesës, të cilat, sipas deklarimeve të saj, së bashku me kursimet e krijuara pas martesë dhe ato të personit të lidhur, kanë shërbyer për financimin e apartamentit në Vlorë, objekt analize.

**20.15** Në përmbyllje të analizës së çështjes së dytë, që lidhet me kursimet në *cash* të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit e të provuara se janë krijuar me burime të ligjshme deri në vitin 2012, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të justifikonte deri në këtë kohë krijimin e kursimeve në vlerën prej 1.789.239 lekësh, kundrejt shumave prej 6.209.000 lekësh ose 5.994.000 lekësh, të pretenduara prej subjektit në gjykim në mënyrë alternative.

- 21.** Lidhur me çështjen e tretë të shtruar për zgjidhje e që u referohet kursimeve të deklaruara në *cash* të personit të lidhur, ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, G. H., në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, në vlerën prej 2.500.000 lekësh dhe në vijim deri në vitin 2012, Kolegji, në përgjigje të pretendimit të Komisionerit Publik, analizoi deklaratimet e tij dhe verifikoi mundësinë e krijimit të kësaj shume të pretenduar, ndër të tjera, si një nga burimet e kursimeve të personit të lidhur që ka krijuar shumën e financuar për blerjen e apartamentit Vlorë.

**21.1** Lidhur me këtë çështje, Komisioni, në analizë të kursimeve të krijuara prej personit të lidhur e të përdorura për krijimin e pasurisë apartament në Vlorë, ka mbajtur qëndrimin se: *Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor për vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, vlerëson se detyrimin për të provuar ligjshmërinë e gjendjes “cash” të deklaruar nga z. G. H. në vitet 2003 – 2004, e ka ky subjekt rivlerësimi, në gjykim nga një trup tjetër, në kuadër të një hetimi të pavarur dhe të paanshëm. Ky konkluzion i trupit gjykues mban në konsideratë edhe faktin se subjekti i rivlerësimit është njohur me ish-bashkëshortin disa vite më vonë se periudha kur është krijuar ky likuiditet.*

**21.2** Komisioneri Publik, duke mos ndarë të njëjtin qëndrim lidhur me kufijtë e kontrollit të pasurisë së personit të lidhur që ka shërbyer për krijimin e pasurisë në Vlorë, ka kërkuar nga Kolegji kontrollin dhe verifikimin e kursimeve të deklaruara prej tij e që janë përdorur si burim për krijimin e shumës me anë të së cilës është financuar blerja e apartamentit në Vlorë. Në

përgjigje të këtij pretendimi, Kolegji ia nënshtroi vlerësimin të tij këto pasuri likuiditet sipas parimeve të përcaktuara prej nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas logjikës se pasuria në fjalë është krijuar me kursime të përbashkëta të bashkëshortëve në një raport bashkëpronësie ideale prej 50% secili, e dhënë e deklaruar prej vetë ish-bashkëshortëve, e cila e bën të pamundur logjikisht përcaktimin e vlerës kontribuuese të secilit, në një kontekst, ku ajo mbetet vetëm në nivel deklarativ.

**21.3** Në logjikën e mësipërme, Kolegji analizoi kursimet *cash* të deklaruara prej personit të lidhur nga viti 2003, në deklaratën fillestare deri në vitin 2012, vit në të cilin ish-bashkëshortët fillojnë të deklarojnë së bashku kursimet e krijuara. Këto kursime përbëhen nga shumat prej 2.500.000 lekësh të deklaruara në deklaratën fillestare të pasurisë dhe kursimet e deklaruara në deklaratat periodike nga viti 2004 – 2012.

**21.4** Lidhur me kursimet e deklaruara në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, prej personit të lidhur G. H., rezulton si vijon:

Në DPV-në fillestare të vitit 2003, personi i lidhur, ka deklaruar: *“Cash” në shtëpi 2.500.000 lekë, me burim nga paga si student i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë dhe nga puna në sektorin privat. Të ardhura të realizuara nga paga mujore gjatë tri viteve si student në Shkollën e Magjistraturës, Tiranë, për periudhën 2000-2003. Të ardhura të realizuara në sektorin privat gjatë periudhës shtator 1995 deri në janar 2000.*

**21.5** Gjatë hetimit administrativ për të provuar punësimin e personit të lidhur në periudhën para vitit 2003 në sektorin privat, janë sjellë prej subjektit dhe administruar në Komision, deklarata noteriale të personave të deklaruar prej personit të lidhur si punëdhënës të tij në këtë periudhë kohore. Në vendimin e Komisionit, lidhur me këto të ardhura, listohen punët e deklaruara nga subjekti si të kryera prej personit të lidhur, dhe deklaratat noteriale të administruara për të provuar këtë punësim, si:

- *menaxher shitjesh dhe shpërndarjeje në pikat e shitjes në Tiranë dhe Institut-Kamëz gjatë periudhës tetor 1995 – tetor 1997, në shoqëritë “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, të cilat ushtronin aktivitet privat në fushën e përpunimit të drithërave. Paga mujore ALL 20.000 lekë, i pasiguruar. Bashkëlidhur deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., dt.10.07.2018, lëshuar nga znj. G. Xh.*
- *shitës në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, gjatë periudhës janar 1998 – dhjetor 1998, bashkëshorti më ka deklaruar se ka punuar me administrator z. V. Ç. dhe pronarë z. V. Ç. dhe z. A. D., me pagë mujore ALL 12.000 lekë në muaj. Bashkëlidhur ka paraqitur dy deklarata noteriale: nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., dt. 05.07.2018, lëshuar nga z. P. A. dhe nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., dt.14.08.2020, lëshuar nga z. V. Ç.*
- *kamerier në “{\*\*\*}”, nga muaji janar 1999 deri në muajin maj të vitit 2000. Ky lokal ka ekzistuar që nga viti 1994 deri në vitin 2004. Paga ka qenë ALL 12.000 lekë në muaj. Bashkëlidhur ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., dt. 26.06.2018, lëshuar nga ish-pronari i këtij lokali, z. H. H.*

**21.6** Kolegji, duke vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit të cilat mbështeten faktin se provohet marrëdhënia e punësimit e personit të lidhur nëpërmjet dokumentacionit të cituar më lart dhe se ai nuk përgjigjet për mospagimin e detyrimeve tatimore prej punëdhënësve të tij, konstatoi se edhe këto pretendime të subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe të pashoqëruara me asnjë dokumentacion të kohës kur pretendohet se ka ndodhur kjo marrëdhënie punësimi.

**21.7** Kolegji konstaton se pagimi i detyrimeve tatimore, ndonëse është një element krejtësisht i paprovuar, madje edhe vetë subjekti i rivlerësimit duket se e pranon që këto detyrime nuk janë

paguar, po jo për faj të personit të lidhur, nuk është kriteri i vetëm që dështon të plotësojë subjekti. Në vlerësimin e Kolegjit, mbeten krejtësisht deklarative e të pambështetura, deklaratimet e subjektit e personit të lidhur për punësimet e tij në vitet 1995-2000, të cilat duken se kanë të vetmet gjurmë, deklaratat noteriale të hartuara nga punëdhënësit e pretenduar, përgjatë periudhës së rivlerësimit. Kolegji ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar rreth vlerës provuese të këtyre deklaratave, kur ato mbeten të pambështetura nga të dhëna apo indicie të tjera që kanë rezultuar nga hetimi. Në këtë kontekst, nuk rezultojnë asnjë deklaratim apo e dhënë në deklaratën fillestare për llojin e punësimit në sektorin privat, punëdhënësit, pagat e përfituara apo çdo detaj tjetër konkret që do të jepnin informacion në një kohë të afërt me periudhën kur ka ekzistuar marrëdhënia. Në të njëjtën mënyrë, subjekti i rivlerësimit nuk jep asnjë informacion as në deklaratimet e dhëna para ILDKPKI-së në vitin 2015, megjithëse është thirrur nga institucioni për të shpjeguar burimet e krijimit të kësaj pasurie. Edhe në këtë moment, personi i lidhur sërish deklaron në mënyrë evazive se të ardhurat, ndër të tjera, janë kursyer nga punësimi në sektorin privat (nga puna në bare, restorante, lojëra fati, këmbim valutash etj.), pa identifikuar asnjë punëdhënës apo punë konkrete të kryer prej tij, aq më pak pagat e përfituara nga këto punësime.

**21.8** Në të njëjtin nivel deklarativ mbeten jo vetëm marrëdhëniet e punësimit të pretenduara, por edhe pagesat e përfituara prej këtyre marrëdhënieve. Të vetmet gjurmë që mbështesin vlerat e pretenduara prej personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, gjenden në deklaratat noteriale të cituara më lart, për vlerën provuese të të cilave është mbajtur tashmë qëndrim prej Kolegjit. Kësaj situatë i shtohet edhe fakti që edhe vetë ekzistenca e këtyre kursimeve mbetet në nivel deklarativ, duke qenë se ato janë deklaruar në gjendjen *cash*, situatë e cila, në mungesë të provueshmërisë së të ardhurës që e ka krijuar, konsiderohet prej Kolegjit jo si një element në favor të subjektit, siç ka potencuar Komisioni, por në të kundërt, si një element që e rëndon subjektin në drejtim të pabesueshmërisë së deklaratimeve.

**21.9** Në këto kushte, Kolegji, në koherencë edhe me jurisprudencën e tij të konsoliduar tashmë<sup>26</sup>, në mungesë të informacioneve që vijnë nga burime të dokumentuara e të besueshme në përputhje me përcaktimin e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë dështuar të provojnë si marrëdhëniet e punësimit të personit të lidhur në vitet 1995-2000, ashtu edhe pagat e përfituara prej tyre, për pasojë Kolegji gjendet në pamundësi të kalkulojë në analizën financiare të këtyre viteve, ndonjë vlerë të provuar se ka ardhur nga punësimi në sektorin privat. Në këto kushte, Kolegji përllogariti si të ardhura në këtë analizë të gjitha të ardhurat e tjera të personit të lidhur, të dokumentuara e për të cilat plotësohen kriteret kushtetuese e ligjore të së ardhurës së ligjshme, si dhe është marrë në konsideratë deklarimi i personit të lidhur dhe i prindërve të tij se ata kanë mbuluar shpenzimet familjare të fëmijëve të tyre.

**21.10** Në përfundim, lidhur me këtë çështje, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provuan krijimin me burime të ligjshme të shumës prej 2.500.000 lekësh në vitin 2003, të deklaruar si gjendje *cash* në banesë nga personi i lidhur në deklaratën fillestare të pasurisë. Deklarimet e tyre për të ardhurat e siguruara prej punësimit të personit të lidhur në sektorin privat, nga viti 1995-2000, u vlerësuan nga Kolegji se mbetën vetëm në nivel deklarativ dhe të pambështetura në asnjë dokument shkresor me vlerë provuese, për pasojë mbeti e paprovuar marrëdhënia e punësimit dhe të ardhurat e fituara prej saj e, për rrjedhojë, edhe pagimi i detyrimeve tatimore që sigurojnë ligjshmërinë e tyre sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>26</sup> *Shih vendimin e Kolegjit nr. 7/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku; vendimin nr. 15/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.*

21.11 Mbështetur në përfundimin e mësipërm, personi i lidhur rezultoi se ishte në mungesë të burimeve të ligjshme për të krijuar shumën e deklaruar në *cash*, në vlerën prej (-)1.281.796 lekësh, për pasojë, do të konsiderohet se kishte mundësi të krijonte deri në vitin 2003, kursime në shumën prej 1.218.204 lekësh.

22. Në vijim, Kolegji analizoi deklaratat e periodike të pasurisë së personit të lidhur, për të përcaktuar gjendjen e *cash*-it që ai mund të kishte si shumatore deri në vitin 2012.

22.1 Në DPV-2004, personi i lidhur ka deklaruar: “*Cash*” në shtëpi 1.500.000 lekë, me burim nga paga si student në Shkollën e magistraturës dhe nga puna në sektorin privat që nga vitit 1995 e në vazhdim deri sot. Nga analiza e deklaratës periodike të këtij viti, rezulton se personi i lidhur ka blerë automjetin tip “Mercedes Benz” për një vlerë prej 1.147.766 lekësh. Kjo vlerë përkon me pakësimin me 1.000.000 lekësh të gjendjes së *cash*-it të deklaruar në vitin 2003 prej 2.500.000 lekësh, duke u konsideruar prej tij se ka mbetur tashmë në banesë gjendja *cash*, prej 1.500.000 lekësh, e krijuar sipas deklaramit me të njëjtat burime si ato të përdorura në vitin 2003. Ndërsa personi i lidhur pretendon se kjo shumë ka mbetur e gjitha në zotërimin e tij në fund të vitit 2004, pra në total 1.500.000 lekë, sipas vlerësimit të Kolegjit, duke marrë në konsideratë konkluzionin e arritur në përcaktimin e vlerës së *cash*-it për vitin 2003, vetëm në shumën 1.218.204 lekë, shuma e mbetur në disponim të personit të lidhur në fund të këtij viti, do të ishte (1.218.204 lekë, *cash* në dispozicion në vitin 2003 – 1.000.000 lekë, vlera e automjetit të blerë në vitin 2004) në vlerën 218.204 lekë dhe jo në vlerën që ka deklaruar personi i lidhur.

22.2 Në DPV-në e vitit 2005, në seksionin “Ndryshimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar gjendje *cash* 350.000 lekë. Subjekti dhe personi i lidhur kanë pretenduar se termi “gjendje” në këtë vit, duhet të kuptojë shtesën e *cash*-it në vlerën e deklaruar për sa kohë që është pasqyruar te rubrika e ndryshimeve të pasurisë. Kolegji vlerësoi të konsiderojë këtë deklaram sipas shpjegimeve që japin subjekti dhe personi i lidhur dhe ta konsiderojë vlerën prej 350.000 lekësh, si kursim të vitit 2005, i cili do t’i shtohet vlerës prej 218.204 lekësh të mbetur sipas përlllogaritjeve më sipër nga kursimet e vitit 2004.

22.3 Në DPV-në e vitit 2006, në seksionin “Ndryshimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtar 350.000 lekë dhe të ardhura si pedagog në Universitetin jopublik {\*\*\*} 250.000 lekë.*

Në seksionin “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike”, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura nga paga vjetore si gjyqtar 350.000 lekë dhe të ardhura si pedagog në Universitetin jopublik {\*\*\*} 250.000 lekë.*

22.4 Në deklaramin e vitit 2007, në seksionin “Të ardhura nga paga”, prej personit të lidhur është shpjeguar që: *Deklaroj se në deklaramin e mëparshëm, të bërë më datë 20.03.2007, për shkak të paqartësisë në përpilimin e deklaratës, kam deklaruar të ardhura të njëjta si në faqen nr. 3, ashtu dhe në faqen nr. 4 të deklaratës, te rubrika e plotësuar si të ardhura nga paga si gjyqtar në Gj. Rrethit Tiranë. Ky deklaram i kësaj shume përfaqëson shumën e kursyer nga unë për periudhën 01.01.2006 deri më 31.12.2006, dhe jo të ardhurat neto nga puna si gjyqtar në këtë periudhë. I njëjti lapsus ekziston edhe në deklaramin e të ardhurave si pedagog, të cilat nuk janë të ardhura të kursyera, por të ardhurat e përfituara për periudhën në fjalë edhe të kursyera.*

22.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: *Njëkohësisht, referuar deklaramit të pasurisë për vitin 2006, dorëzuar pranë ILDKPKI-së në dt. 20.03.2007 nga ish-bashkëshorti im, z. G. H., ka rezultuar se kursimet e këtij shtetasi nga paga e përfitur prej tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vitin 2006, kanë qenë në shumën 350.000 lekë.*

**22.6** Kolegji, në kushtet e paqartësisë që sjellin deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për gjendjen e *cash*-it në vitin 2006, jo vetëm për faktin që konfundojnë termin të *ardhura* me *kursime*, por edhe për mungesën e koherencës dhe kundërshtitë mes qëndrimeve të dy ish-bashkëshorteve për gjendjen *cash* të kursyer, analizoi të gjitha deklaratimet e tyre, përfshi ato të bëra në vitin 2007 prej personit të lidhur, të cilat kanë shëruar defektin në deklarime për vitin 2006, në raport me të dhënat që u përfatuan nga dokumenti i lëshuar prej Universitetit jopublik {\*\*\*} (pa numër protokolli), datë 26.10.2016.

**22.7** Në vërtetimin e Universitetit jopublik {\*\*\*}, të datës 26.10.2016, deklarohet se të ardhurat neto të përfituara prej personit të lidhur nga angazhimi si pedagog te ky universitet, për periudhën janar 2004 – dhjetor 2008, janë në shumën 392.940 lekë. Me qëllim identifikimin e shumave që personi i lidhur ka përfitur nga mësimdhënia vit mbas viti, Kolegji i analizoi të dhënat e këtij vërtetimi në raport me deklaratimet periodike që personi i lidhur ka bërë për vitet 2004 - 2008, duke konkluduar si vijon:

- Për vitin 2004, në DPV-në e këtij viti, personi i lidhur kishte deklaruar se pagesa për mësimdhënie ishte 2.000 lekë për seminar dhe kryerjen në çdo muaj të 4-5 seminare. Meqenëse shkresa e lëshuar nga universiteti konfirmonte periudhën e fillimit në tetor 2004, Kolegji përllorarit të ardhurat për tre muaj, të cilat rezultojnë në shumën 30.000 lekë (3 muaj  $\times$  2.000 lekë  $\times$  5 seminare).
- Për vitin 2005, personi i lidhur kishte deklaruar në DPV-në e këtij viti se pagesa për mësimdhënien ishte 2.000 lekë për seminar dhe kryerjen në çdo muaj të 4-5 seminare. Kolegji përllorarit të ardhurat për vitin 2005, të cilat rezultojnë në shumën 90.000 lekë (9 muaj  $\times$  2.000 lekë  $\times$  5 seminare).
- Për llogaritjen e të ardhurave në vitin 2006, nga ana e Kolegjit, u morën fillimisht në konsideratë derdhjet bankare të kryera nga Universiteti jopublik {\*\*\*} në emër të personit të lidhur pranë Bankës Intesa Sanpaolo, të cilat konfirmonin për vitin 2007, pagesa në shumën totale prej 35.550 lekësh, të cilat u përkisnin tre muajve të mësimdhënies dhe dy pagesa të tjera në shumën 30.690 lekë, të kryera në vitin 2008. Për të identifikuar shumën korresponduese të vitit 2006, nga totali i shumës së konfirmuar nga shkresa e Universitetit {\*\*\*}, u zbritën shifrat për vitet 2004, 2005 dhe pagesat e konfirmuara nga banka dhe diferenca e mbetur prej 206.700 lekësh u pjesëtua me 21 muaj (12 muaj që i përkisnin vitit 2006 dhe 9 muaj që i përkisnin vitit 2007) me një rezultat prej 9.843 lekësh në muaj. Mbështetur në këtë metodologji, shuma e të ardhurave për vitin 2006, nga ana e Kolegjit, u përllorarit në masën 118.114 lekë (9.843 leke  $\times$  12 muaj). Për vitin 2007, shuma e të ardhurave të përllorarit nga Kolegji, ishte në masën 124.136 lekë (9.843 leke  $\times$  9 muaj + 35.550 lekë).
- Për vitin 2008, shuma e të ardhurave të përllorarit u konsiderua shuma e konfirmuar nga të dhënat e llogarisë bankare të personit të lidhur pranë Bankës Intesa Sanpaolo, prej 30.690 lekësh.

**22.8** Në kushtet e mësipërme, edhe pse në DPV-në e vitit 2006, prej personit të lidhur në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, janë deklaruar të ardhura nga paga si gjyqtar dhe nga puna si pedagog në Universitetin {\*\*\*}, në shumën totale prej 600.000 lekësh dhe nuk është deklaruar specifikisht “kursime në *cash*”, sqarimet e dhëna në deklaratën vijuese të vitit 2007, referuar mënyrës së deklaratimit të DPV-së, konsiderohen si të mirëqena dhe të tilla që qartësojnë qëllimin dhe synimin e deklaratimit të personit të lidhur, referuar situatës së kursimeve në vitin 2006. Gjithashtu, duke konsideruar që paga e përfitur si gjyqtar në vitin 2006, në totalin e saj ka qenë më e madhe se vlera 350.000 lekë, e deklaruar prej personit të lidhur si pagë/kursim në DPV-në e vitit 2006, arrihet në konkluzionin se vlera e deklaruar prej



personit të lidhur si pagë në vitin 2006, ka qenë vlerë e destinuar për t'u deklaruar si kursim dhe në analizën financiare të Kolegjit, ajo u trajtua si e tillë.

**22.9** Gjithashtu, pavarësisht se subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, sqaron se shuma e kursyer në vitin 2006 prej personit të lidhur është vetëm 350.000 lekë, e cila është kursim nga të ardhurat e punës si gjyqtar dhe jo pjesa tjetër prej 250.000 lekësh, që janë të ardhurat nga puna si pedagog në Universitetin jopublik {\*\*\*}, Kolegji, duke i dhënë prioritet deklarimit të personit të lidhur, sa kohë që flitet për kursimet e tij personale, si edhe duke trajtuar në mënyrë garantiste, informacionin e ekstraktuar prej shkresës së Universitetit jopublik {\*\*\*}, vlerësoi të konsiderojë si vlerë të kursyer të gjithë shumën që rezultoi se ka përfituar personi i lidhur nga ky universitet në vitin 2006, në vlerën 118.114 lekë. Në këto rrethana, Kolegji do të konsiderojë si kursim për vitin 2006, për personin e lidhur, shumën prej 468.114 lekësh, e cila do të llogaritet si e tillë në analizën financiare të Kolegjit.

**22.10** Në DPV-në e vitit 2007, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar: *Në përfundim të këtij viti, kam pasur një shtim të pasurisë personale, në vlerën monetare 100.000 lekë, vlerë e cila nuk ka pasur kontestime apo debat përgjatë procesit, për pasojë do të jetë e njëjtë me atë që ka deklaruar personi i lidhur.*

**22.11** Në DPV-në e vitit 2008, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar: *Kursime nga paga si gjyqtar dhe shpërblime si ekspert në Shkollën e Magjistraturës, edhe pedagog në Universitetin {\*\*\*}, 200.000 lekë, vlerë e cila nuk ka pasur kontestime apo debat përgjatë procesit, për pasojë do të jetë e njëjtë me atë që ka deklaruar personi i lidhur.*

**22.12** Në DPV-në e vitit 2009, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar: *Kursime nga paga si gjyqtar dhe shpërblime si ekspert në Shkollën e Magjistraturës dhe OSBE 400.000 lekë.*

**22.13** Në DPV-në e vitit 2010, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, personi i lidhur ka deklaruar: *Kursime nga paga si gjyqtar dhe shpërblime si ekspert në Shkollën e Magjistraturës dhe OSBE 350.000 lekë.*

**22.14** Për të dyja këto vite deklarimi, Komisioneri Publik kishte ngritur si shkak ankimi pretendime rreth provueshmërisë së pagimit të detyrimeve tatimore për shumën e përfituara prej OSBE-së, të cilat duhet t'i nënshtroheshin hetimit. Kolegji, pasi u njoh me pretendimin e subjektit për të ardhurat e përfituara nga ish-bashkëshorti nga shërbimi i ofruar prej tij pranë OSBE-së, si dhe pasi analizoi përmbajtjen e provës së re të sjellë nga subjekti përgjatë gjykimit në Kolegji, “Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Pranisë së OSBE-së në Shqipëri”, si edhe me qëndrimin e Komisionerit Publik i cili e konsideroi të drejtë dhe të mbështetur në prova pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizë shumën e përfituara nga personi i lidhur në vlerën (+)150.887 lekë për vitin 2009 dhe shumën (+) 101.810 lekë për vitin 2010, edhe pse jo e vetmja rrethanë që çonte në një balancë pozitive, konsideroi të konfirmuara kursimet e deklaruara prej personit të lidhur në vlerat 400.000 lekë në vitin 2010 dhe 350.000 lekë në vitin 2010.

**22.15** Në konkluzion të qëndrimeve si më sipër, duke llogaritur të gjitha kursimet e personit të lidhur të deklaruara si të tilla, deri në vitin 2010, rezulton se ai kishte mundësi të dispononte në fund të këtij viti si kursim, shumën prej 2.086.318 lekësh.

**22.16** Në DPV-në e vitit 2011, personi i lidhur, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar blerjen e apartamentit dhe shlyerjen e shumës 1.500.000 lekë, të siguruar nga kursimet personale ndër vite.

Në mbështetje të këtyre deklarimeve, Kolegji zbriti nga shuma që personi i lidhur dispononte, sipas analizës financiare të Kolegjit, prej 2.086.318 lekësh, shumën prej 1.500.000 lekësh dhe rezultantja prej 586.318 lekësh përfaqëson vlerën e kursimeve të mbetura në dispozicion të personit të lidhur, pas pagimit të këtij kësti.

**22.17** Në DPV-në e vitit 2011, personi i lidhur, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar: *shitje automjeti “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, me anë të kontratës së premtimit të shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.03.2011 dhe kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 29.10.2011, lidhur përpara noterës znj. M. Ll., me blerës z. E. G., me vlerë 1.200.000 lekë.*

**22.18** Komisioneri Publik, rreth këtij transaksioni, ka ngritur pretendimin se kjo shumë nuk duhet të konsiderohet si kursim i personit të lidhur në vitin 2011 dhe, për pasojë, nuk duhet të përfshihet në kursimet e këtij të fundit, për sa kohë ajo nuk është deklaruar si shtesë e likuiditeteve në fund të këtij viti, dhe që afekton kursimet e personit të lidhur në funksion të blerjes së pasurisë apartament në Vlorë. Përgjatë hetimit administrativ në Komision, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, por edhe në gjykim, subjekti i rivlerësimit ka specifikuar se shuma e përfituar nga bashkëshorti nga shitja e këtij automjeti në vitin 2011, ka shërbyer si kursim në *cash*.

**22.19** Komisioni, lidhur me këtë shumë, ka mbajtur qëndrimin se: *[...] Lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2011, trupi gjykues, pasi analizoi deklarin periodik të z. G. H. në vitin 2011, konstatoi se shuma 1.200.000 lekë nuk rezulton të jetë deklaruar si shtesë e gjendjes “cash” në fund të vitit 2011 prej tij. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për këtë gjendje “cash” të disponueshme në vitin 2011, është i pambështetur në prova, pasi në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, ky deklarin periodik vjetor i vitit 2011, përbën provë për të mos mbështetur pretendimin e subjektit mbi këtë gjendje “cash”.*

**22.20** Kolegji, pasi analizoi deklarinmet e personit të lidhur në deklaratën periodike të vitit 2011, arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik është i drejtë. Në këtë deklaratë, personi i lidhur ka deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë, shitjen e automjetit në pronësi të tij dhe vlerën prej 1.200.000 lekësh të fituar prej këtij transaksioni. Në këtë deklaratë, kjo shumë nuk është përshkruar si kursim i personit të lidhur në fund të vitit 2011, por vetëm si e ardhur e krijuar prej shitjes së pasurisë automjet, si një detyrim që vjen për shkak të ndryshimit të të drejtave të pronësisë së personit të lidhur mbi një pasuri të luajtshme në pronësi të tij përgjatë vitit deklarues. Përveç se është deklaruar vetëm si një vlerë e përfituar nga shitja e kësaj pasurie, ajo nuk është kualifikuar si kursim i këtij viti, siç personi i lidhur ka bërë në të gjitha vitet pararendëse, por edhe në vijim, dhe as rezulton të jetë identifikuar në ndonjë mënyrë në deklarinmet e mëpasshme si burim për krijimin e ndonjë pasurie. Madje edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, kjo shumë është deklaruar vetëm si një nga të adhuruat e krijuara prej personit të lidhur, por ajo nuk është saktësuar apo identifikuar se është përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie, qoftë ajo likuiditet, pasuri e paluajtshme apo e luajtshme. Në ndryshim nga kjo situatë, në deklaratën *vetting*, personi i lidhur, kur ka deklaruar si të ardhur shumën e përfituar prej shitjes së një automjeti tjetër, e ka identifikuar

atë si burim për financimin e automjetit “Mercedes Benz” të sipërpërmendur, duke e identifikuar atë shumë posaçërisht si të tillë<sup>27</sup>. Ky veprim mungon të jetë kryer për shumën prej 1.200.000 lekësh, e cila pretendohet të jetë përdorur për të krijuar kursime dhe më pas si burim për krijimin e pasurive të bashkëshortëve, element që përforcon bindjen se kjo shumë nuk ka shërbyer për krijimin e kursimeve në *cash* dhe as për financimin e ndonjë pasurie, por është shpenzuar përgjatë vitit financiar njësoj si të ardhurat e tjera të personit të lidhur.

**22.21** Përveç sa më lart, nga një lexim i ngjarjeve financiare të vitit 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, të cilët deklarojnë se kanë nisur bashkëjetesën në këtë vit, kanë kryer transaksione të rëndësishme financiare dhe jo vetëm, të cilat deduktohet në konkluzion të analizës së fakteve në vijim, se janë të mbështetura financiarisht edhe nga përdorimi i kësaj shume. Kështu, në këtë vit, rezulton se: **(i)** personi i lidhur ka kryer pagesën e këstit të apartamentit në Tiranë, në vlerën prej 1.500.000 lekësh dhe deklaroi se bashkë me subjektin kanë filluar të bashkëjetojnë në apartament të ri; **(ii)** në muajin shkurt të këtij viti, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shlyer kredinë në Bankën Emporiki, në vlerën prej 25.000 eurosh, me anë të huas/dhurimit të prindërve të saj, shumë e cila iu nënshtrua hetimit gjyqësor, por nuk u bë pjesë e këtij vendimi për shkak të heqjes dorë prej këtij shkak ankimi nga ana e Komisionerit Publik në konkluzione përfundimtare<sup>28</sup>; **(iii)** në korrik të këtij viti, është blerë prej babait të personit të lidhur automjeti tip “Audi Q7” për një vlerë prej 4,9 milionë lekësh, e cila siç pretendon personi i lidhur<sup>29</sup>, është blerë për shkak të një ekonomie të përbashkët të tij me familjen, përfshirë edhe të ardhurat e tij në vite, çështje e cila gjithashtu iu nënshtrua hetimit gjyqësor, por nuk u bë pjesë e këtij vendimi sepse Komisioneri Publik hoqi dorë nga shkak i ankimit që lidhej me këtë pasuri në konkluzionet përfundimtare<sup>30</sup>; **(iv)** nga vlera prej 1.200.000 lekësh, e përfituar prej shitjes së automjetit, shuma prej 1.000.000 lekësh është marrë paraprakisht nga personi i lidhur që në muajin mars, kur ka lidhur kontratën paraprake të shitjes, siç rezultoi nga kjo kontratë, për pasojë ajo është disponuar lirisht pothuaj përgjatë gjithë këtij viti kalendarik e financiar për nevoja të familjes së subjektit të rivlerësimit.

Në këto kushte, duke analizuar rrethanat faktike që u renditën më lart, personi i lidhur ka pasur mjaftueshëm arsye të rëndësishme për të shpenzuar shumën e përfituar prej shitjes së automjetit. Në këtë kuptim, mosdeklarimi i shumës prej 1.200.000 lekësh si kursim në fund të vitit kalendarik 2011, nuk është një haresë apo pasaktësi në deklaram, por në vlerësimin e Kolegjit, për ligj dhe përfaqëson realisht situatën financiare të personit të lidhur dhe subjektit në këtë vit.

**22.22** Për sa më sipër, duke vlerësuar rastin në raport me detyrimet ligjore, si dhe mbështetur në interpretimin e bërë prej jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, lidhur me provueshmërinë e kursimeve në *cash*, nëpërmjet deklaramit të tyre si të tilla në deklaratën periodike vjetore në të

<sup>27</sup> Në deklaratën vetting, personi i lidhur, në seksionin “Angazhime nga veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, në rubrikën me numrin 12, ka deklaruar: “Të ardhura neto të përfituara nga shitja e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, në shumën 11.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., lidhur para noteres I. B. Kjo shumë u përdor e gjitha për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” nga z. A. H., për shumën 1.500.000 lekë, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.05.2007, redaktuar para noteres A. M.-H., Tiranë”.

<sup>28</sup> Nga analiza e kryer në Kolegj, rezultoi se prindërit e subjektit, me të ardhurat e siguruar nga pensionet ndër vite, nuk kishin të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar kostot e jetesës dhe për t’i dhënë hua subjektit shumën 25.000 euro në vitin 2009. Nëse pjesë e kësaj analize përfshihej si e ardhur shuma prej 40.000 lekësh/muaj, që prindërve u kishte dhënë si ndihmë, vajza e tyre A. Ç. (Ll.), prindërit kishin mundësi për të krijuar shumën 25.000 euro.

<sup>29</sup> Referuar pretendimeve në çështjen e subjektit të rivlerësimit G. H., të administruara për shkak të vendimit të ndërmjetëm të trupës gjyqësore të datës 04.05.2022.

<sup>30</sup> Nga analiza e kryer në Kolegj, rezultoi se nga babai i ish-bashkëshortit të subjektit, në korrik 2011, është blerë automjeti tip “Audi Q7”, por ai rezultoi me situatë ekonomike financiare të mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen këtij automjeti, në vlerën (-) 4.995.395 lekë.

cilën ato krijohen, trupi gjykues nuk e konsideroi këtë të ardhur si kursim i krijuar në vitin kalendarik 2011 dhe, për pasojë, kjo shumë nuk u përfshi në volumin e kursimeve *cash* që janë përdorur sipas deklarimeve të subjektit në blerjen e pasurisë apartament në Vlorë në vitin 2016.

**22.23** Në konkluzion të kësaj analize që lidhet me kursimet në *cash* të personit të lidhur, nga analiza e Kolegjit, rezulton se personi i lidhur në fund të vitit 2011 dispononte hipotetikisht likuiditet në gjendje *cash* në vlerën prej 586.318 lekësh.

**22.24** Gjendja *cash* e personit të lidhur është pakësuar në analizën financiare të kryer në Kolegji, njësoj si edhe për subjektin e rivlerësimit në vitin 2012, në të cilin ish-bashkëshortët përballojnë me kursimet personale, por të ndara në mënyrë të barabartë, blerjen e automjetit tip “Citroen C4”. Për shkak të financimit të kësaj pasurie, gjendja e kursimeve *cash* të personit të lidhur në vitin 2012, pas pakësimit të *cash*-it në shumën prej 586.318 lekësh, rezulton të mbetet në vlerën “0” lekë.

**22.25** Për sa më sipër, në referim të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur në deklaratat periodike të viteve 2013, 2014, 2015 e 2016<sup>31</sup>, gjendja e likuiditeteve *cash* të ish-bashkëshortëve në vitin 2014 shtohet në vlerën prej 300.000 lekësh, në vitin 2015 kjo gjendje pakësohet në vlerën prej 800.000 lekësh dhe më pas shtohet në vitin 2016 në vlerën prej 500.000 lekësh. Në konsideratë edhe të këtyre deklarimeve, gjendja e *cash*-it të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në momentin e blerjes së apartamentit në shtator të vitit 2016, ka qenë e mbuluar me burime të ligjshme deri në vlerën prej 1.014.851 lekësh, të cilat janë llogaritur si burime të ligjshme për financimin e pasurisë apartament në Vlorë, objekt analize, kur ndërkohë, sipas kontratës së shitblerjes, vlera e blerjes së kësaj pasurie është 55.000 euro, ekuivalente me 7.615.223 lekë.

**23.** Kolegji mori në shqyrtim edhe çështjen e katërt të shtruar për zgjidhje që lidhet me pretendimin e Komisionerit Publik, se në drejtim të analizës financiare, për diferencat negative në vitet 2012 dhe 2016, përfundimi i arritur nga Komisioni për reduktimin e shpenzimeve të udhëtimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, bazuar vetëm në deklaratimet e subjektit dhe shpjegimet e dhëna në deklaratat noteriale (të motrës dhe bashkëshortit të saj), të hartuara gjatë hetimit administrativ, mbetet i paqartë dhe jo i provuar. Për këtë çështje, Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji të kryejë rivlerësimin e argumenteve të përdorura nga Komisioni lidhur me këto shpenzime, çka eventualisht, sipas tij, do të ndikonte në mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe investimet e këtyre viteve.

**23.1** Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, lidhur me kostot e shpenzimeve të udhëtimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, dhe të familjes së saj, qëndrimi i mbajtur është si vijon: *Në deklarin e mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit prej motrës së subjektit, në rastet e disa udhëtimeve të përbashkëta, kryer prej tyre, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe:*

---

<sup>31</sup> *Deklarimet e kursimeve në “cash” të subjektit dhe të personit të lidhur në DPV 2013 – 2016 janë:*

- Në DPV-në e vitit 2013, subjekti nuk deklaroi shtesë/pakësim *cash*.

- Në DPV-në e vitit 2014, subjekti deklaroi shtuar në “*cash*”, shumën 300.000 lekë. Në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar “Kursime nga të ardhurat vjetore të miat dhe të bashkëshortit, të cilat u shtohen shumave të kursyera dhe të deklaruara ndër vite”.

- Në DPV-në e vitit 2015, subjekti deklaroi pakësim “*cash*-i”, në shumën 800.000 lekë. Në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: “Pakësim i kursimeve të mbledhura ndër vite “*cash*” në banesë”.

- Në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaroi gjendje “*cash*” në banesë 500.000 lekë.

- *marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me motrën e saj, marrëdhënie familjare e vazhdueshme, e pasqyruar në ndihmën e vazhdueshme që subjekti ka pasur, ndër vite, nga motra e saj;*
- *faktin që subjekti nuk gjendet në kushtet e një trajtimi preferencial, i cili duhej të deklarohet para organit kompetent ILDKPKI-së, mbi këto pagesa të cilat nuk kalonin as pragun e deklarimit;*
- *faktin që nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, u provua mundësia financiare e motrës së subjektit dhe e bashkëshortit të saj për të mbuluar këto shpenzime të udhëtimeve të përbashkëta;*
- *faktin që nga verifikimi në sistemin TIMS, rezultoi se këto udhëtime janë kryer bashkërisht nga familja e subjektit me familjen e motrës, dhe u deklaruan nga subjekti në pyetësorin standard. Trupi gjyqësor, pasi administroi shpjegimet e subjektit, vlerësoi provat e paraqitura, arriti në përfundimin se deklarimi i subjektit për mbulimin e kostove të qëndrimit në udhëtimet e përbashkëta disaditore prej motrës, duhet të pranohet dhe, për rrjedhojë, duhen zbritur këto kosto qëndrimesh për udhëtimet në analizën finale financiare në vitin 2016, në vlerën 207.639 lekë.*

**23.2** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar që, në analizën e viteve 2012 dhe 2016, vlerat e shpenzimeve të udhëtimit duhet të jetë e njëjtë me atë të përfshirë në analizën e Komisionit, respektivisht prej 96.300 lekësh dhe 382.473 lekë. Subjekti i rivlerësimit, përgjatë gjykimit në Kolegj, ashtu si edhe në Komision, pretendoi që shpenzimet e udhëtimit në çdo rast që ka udhëtuar me motrën e saj, janë mbuluar nga kjo e fundit.

**23.3** Lidhur me shpenzimet e udhëtimit, Kolegji konstatoi se nga aktet e administruara në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton që subjekti, me përgjegjet e pyetësorit nr. 1, ka deklaruar 47 udhëtime familjare dhe individuale dhe 19 udhëtime të veçanta të bashkëshortit, të cilat në total përbëjnë gjithsej 66 udhëtime. Në tërësinë e këtyre udhëtimeve, subjekti vetëm në 5 raste ka deklaruar se ka udhëtuar me motrën apo ka shkuar te fëmijët e saj dhe vetëm në 2 udhëtime të personit të lidhur, ka deklaruar se kostot e udhëtimit janë mbuluar nga bashkëshorti i motrës, z. A. Ç., si President i {\*\*\*}. Kolegji konstaton se gjatë procesit të hetimit në Komision, subjekti, së bashku me shpjegimet për rezultatet paraprake të hetimit, pas kalimit të barrës së provës, i ka përcjellë Komisionit edhe një tabelë lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, tek e cila konstatohet se për shumë udhëtime, ajo deklaroi: *Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit janë përbulluar nga zonja A. Ç. Apo: Nuk ka kosto udhëtimi për shkak se kemi udhëtuar me makinën e zotit A. Ç.*

**23.4** Në drejtim të shpenzimeve të udhëtimit, Kolegji vëren se, referuar deklarimeve në deklaratat periodike vjetore, në asnjë rast subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se kostot e udhëtimit janë mbuluar nga motra e saj. Gjithashtu, edhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk ka mundur të paraqesë ndonjë akt apo të dhënë, si pagesa biletash etj., që faktojnë mbulimin e kostove të shpenzimeve të këtyre udhëtimeve nga motra e saj. I vetmi akt i sjellë nga subjekti për të mbështetur pretendimin e saj se shpenzimet e disa udhëtimeve janë mbuluar nga motra, është sërish “Deklaratë noteriale” me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.02.2020, e lëshuar prej znj. A. dhe z. A. Ç. për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën 2004-2018, për subjektin dhe familjen e saj.

**23.5** Për sa më lart, konstatohet se Komisionit, për udhëtimet për të cilat nga sistemi TIMS, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar së bashku me motrën e saj, nisur nga ky fakt, ka pranuar se shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar prej saj. Nisur nga metodologjia e aplikuar deri aktualisht nga Kolegji, konstatohet se në asnjë rast nuk është aplikuar/pranuar që të gjitha

shpenzimet, si të udhëtimit, edhe ato të qëndrimit, të mbulohen nga personat e tretë. Sipas metodologjisë së Kolegjit për udhëtimet, është pranuar që subjektet në rastet kur provojnë qëndrimin e tyre të afërmit, qofshin këta edhe familjarë të ngushtë, si prindër apo fëmijë, subjektet të ngarkohen me një shpenzim minimal ditor prej 5 eurosh, si dhe me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, si biletë avioni, trageti, karburant makine etj.

**23.6** Në këto kushte, Kolegji, në zbatim të standardit të tij të deritanishëm të aplikuar për evidentimin e kostove të udhëtimit për subjektet e rivlerësimit, aplikoi metodologjinë e tij të dhënë në vendimin (JR) 11/2019, pas së cilës rezultoi që në vitin 2012, shpenzimet e udhëtimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, dhe të familjes së saj ishin në vlerën 246.209 lekë dhe për vitin 2016, ishin në vlerën 489.746 lekë. Përfshirja e këtyre vlerave në analizën ekonomike të këtyre viteve, si dhe e gjendjes së kursimeve në *cash* nga subjekti dhe personi i lidhur, siç u konkludua më sipër, evidentoi se gjendja financiare e tyre për vitin 2012, rezultoi me situatë pozitive në vlerën (+) 420.894 lekë dhe për vitin 2016, në situatë negative në vlerën (-) 6.252.091 lekë. Kjo mënyrë analize e shpenzimeve për udhëtime mbështet edhe nga deklarimi që ka bërë personi i lidhur për vlerën e këtyre shpenzimeve në DPV-në e vitit 2016, tek e cila ka deklaruar në rubrikën “Shpenzime të deklarueshme”, se ka kryer “shpenzime për pushime brenda dhe jashtë vendit jo më shumë se 500.000 lekë”.

24. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Kolegji, pasi analizoi dhe vlerësoi kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, të deklaruara në deklarata fillestare të pasurisë, si edhe deklaratimet për shtesat e kurimeve në *cash* në vitet 2006-2010 e më pas, në raport me të gjitha faktet e provuara nga aktet shkresore të administruara përgjatë hetimit administrativ dhe atij gjyqësor, vlerësoi shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit për subjektin dhe personin e lidhur për vitin 2016, kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të financuar me burime të ligjshme pasurinë apartament të ndodhur në Vlorë, duke llogaritur si burime të krijimit të saj vetëm të ardhurat që rezultuan të provuara sipas konkluzioneve të mësipërme. Mbështetur në rezultatet e kësaj analize, Kolegji arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjendeshin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie dhe përbalimin e shpenzimeve për vitin 2016, në vlerën prej (-) 6.252.091 lekësh, situatë faktike e cila kualifikohet sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
25. Për sa më sipër, Kolegji çmon se mungesa e burimeve të ligjshme që lidhet me kursimet në *cash* të subjektit të rivlerësimit e të personit të lidhur, të cilat janë përdorur për blerjen e pasurisë apartament në Vlorë, konsiderohen në një nivel të lartë dhe të pajustificueshëm, duke mos kënaqur standardin kushtetues të parashikuar nga neni D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës për provueshmërinë bindshëm të burimeve të ligjshme të pasurive në pronësi, për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila urdhëron vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
26. Kolegji nuk ia nënshtroi shqyrtimit të tij shkaqet e tjera të ankimit, prej të cilave, pas zhvillimit të hetimit e debatit gjyqësor, Komisioneri Publik hoqi dorë në bisedimet përfundimtare e, për pasojë, mbetën jashtë objektit e kufijve të shqyrtimit të çështjes.
27. Në këto kushte, Kolegji arrin në konkluzionin se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, është marrë i pambështetur në fakte të provuara gjatë hetimit administrativ dhe në zbatim të gabuar të ligjit e, për pasojë, duhet të ndryshohet.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 342, datë 02.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 06.07.2022.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi - kundër*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi - kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit nr. 26, datë 06.07.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit nr. 342, datë 02.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, me funksionin gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: *i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
3. Komisioni, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka dalë në këto përfundime:  
*[...] subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj [...].*
4. Shqyrtimi i çështjes në Kolegj është bërë në bazë të ankimit të Komisionerit Publik, nëpërmjet të cilit është kërkuar marrja në shqyrtim e shkaqeve ankimore dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë në mënyrë alternative: *ndryshimin e vendimit nr. 342, datë 2.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose: lënien në fuqi të këtij vendimi.*
5. Shumica e trupit gjykues, pas shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila urdhëron vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
6. Duke shprehur dakordësisë me vlerësimin ligjor dhe financiar në mendimin e pakicës së gjyqtarës Albana Shtylla, unë gjyqtarja në pakicë do të doja të argumentoja qëndrimin tim kundër arsyetimit të përdorur nga shumica e trupit gjykues në marrjen e vendimit për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, për sa parashtrij në mënyrë të përmbledhur në vijim.
  - 6.1 Në vlerësim të fakteve të provuara në bazë të provave të administruara, parë në harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes, lidhur me personin tjetër të lidhur sipas ligjit, me subjektin e rivlerësimit, motra e subjektit të rivlerësimit, znj. A. Ç., plotëson kriteret ligjore të parashikuara në nenin 3, pika 14 dhe nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të lidhjeve të interesit pasuror mes tyre.
  - 6.2 Normat kushtetuese, në harmoni me kërkesat e ligjit të posaçëm nr. 84/2016, orientojnë organet e rivlerësimit të provojnë ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur në rastet kur provohet marrëdhënia e interesit pasuror apo e dhurimit me subjektin e rivlerësimit. Në rastin konkret, rezultatet e analizës ligjore dhe financiare të kryer si në Komision, ashtu dhe në Kolegj provuan se motra e subjektit të rivlerësimit [personi tjetër i lidhur] ka pasur të ardhura të ligjshme disa herë më shumë sesa shumat e dhuruara motrës së saj, subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri. Gjithashtu, nga analizimi i dokumentacionit justifikues ligjor, znj. A. Ç. rezulton të jetë tatimpaguese e rregullt e shtetit shqiptar.



6.3 Përveçse të ardhurave të ligjshme, lidhjet e interesit pasuror dhe dhurimet janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore që nga viti 2004 deri në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përmbushje të kërkesave ligjore në fuqi, si dhe në shpjegimet e dhëna në kuadër procesit të rivlerësimit si në Komision, ashtu dhe në Kolegj, duke qenë konsekuente në argumentet e saj.

6.4 Në kushtet kur lidhjet e interesit pasuror janë të provuara, dhurimet justifikohen me të ardhura të ligjshme, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, e për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, në vlerësimin tim përmbushin plotësisht kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.*

6.5 Shumica e trupit gjykues nuk duhej të linte jashtë vëmendjes shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës gjyqësore publike për disa rrethana specifike që justifikonin kujdesin e shtuar të motrës ndaj subjektit të rivlerësimit, për më tepër që kushtet ekonomiko-financiare të saj e mundësonin lehtësisht këtë kujdes të ofruar prej periudhës studentore, përpara emërimit të saj në funksionin e gjyqtares, e në vazhdimësi.

6.6 Nga analizimi i dokumentacionit bankar të administruar, rezulton se tarifat për diplomimin/doktoratën e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, biletat e udhëtimit etj. janë paguar nga motra e subjektit, znj. A. Ç., fakt ky që mbështet deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përgjatë procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga dokumentacioni, rezulton se në kontratën e kredisë të vitit 2011, mes personit të lidhur G. H. dhe Bankës Kombëtare Tregtare, për blerje apartamenti, rezulton se A. Ç. dhe bashkëshorti i saj në këtë kontratë kanë qenë në cilësinë e *dorëzanësve*. *Sipas dokumentacionit dhe në përputhje me shpjegimet e dhëna*, mbështetja nga motra e saj ka filluar para ushtrimit të detyrës së gjyqtares dhe ka vazhduar, duke u deklaruar në vitet periodike përkatëse. Ajo nuk u shfaq në periudhën e rivlerësimit, siç ka ndodhur me subjekte të tjera, por në rastin konkret ka filluar që në arsimimin e subjektit të rivlerësimit, e deri më sot. Prandaj shumica e trupit gjykues duhej të kishte pasur parasysh rolin e gjykatës, e cila në bazë të provave dhe fakteve të provuara, krijon bindjen që ky subjekt është i sinqertë në deklaratimet e tij dhe duhet konfirmuar në detyrë.

6.7 Sa u përket kontratave të shitblerjes së apartamenteve objekt gjykimi, ato janë lidhur mes subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur në cilësinë e blerësit dhe motrës së subjektit të rivlerësimit, së bashku me bashkëshortin e saj, në cilësinë e shitësit, ku në përmbajtje të kontratës së shitjes, datë 10 tetor 2012, me nr. rep. {\*\*\*}, nr. kol. {\*\*\*}, në nenin 3 të saj [*Çmimi i kontratës*] është parashikuar shprehimisht se *çmimi është preferencial, për shkak të marrëdhënieve të ngushta gjinore midis palëve kontraktore shitës-blerës.*

6.8 Ndodhur në këtë situatë faktike dhe ligjore, çmoj se nga shumica e trupit gjykues duhet të ishin marrë si të ligjshme, në kuadër të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të gjitha të ardhurat e personit tjetër të lidhur, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

6.9 Sipas analizës më sipër, mungesa e një *connecti* ligjor mes motrave nuk mund të zhbëjë një mori faktesh bindëse, se kjo marrëdhënie mes tyre ka ekzistuar dhe personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura të ligjshme për t'i dhuruar, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

6.10 Gjithashtu, shumica e trupit gjykues duhet të kishte pasur parasysh edhe formimin e saj si magjistrate e shkëlqyer, gjë e cila doli në pah gjatë gjykimit të çështjes, dhe qëllimin e ligjit, largimin nga sistemi të gjyqtarëve dhe prokurorëve etj., të cilët nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji, gjë e cila në rastin e gjyqtares Elbana Lluri është e kundërta, ajo ka përmbushur kërkesat e ligjit dhe e meritonte të ishte pjesë e sistemit të drejtësisë.

7. Në përfundim të sa arsyetuar, çmoj se shumica e trupit gjykues duhet të kishte vlerësuar me objektivitet provat e administruara në raport me rrethanat e çështjes, të cilat, në vlerësimin tim, plotësonin kërkesat kushtetuese e ligjore dhe, për rrjedhojë, në zbatim nenit 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, të vendoste lënien në fuqi të vendimit nr. 342, datë 02.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elbana Lluri.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, votova kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri. Në vlerësimin tim, në analizë të fakteve dhe provave të administruara dhe pretendimeve të paraqitura në ankim, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Për këtë arsye, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 342, datë 02.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Siç rezulton nga vendimi i shumicës për këtë çështje, subjekti i rivlerësimit është konsideruar se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve në *cash* të saj dhe të personit të lidhur, të cilat janë përdorur për blerjen e pasurisë apartament në Vlorë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në shumën prej 6.252.091 lekësh dhe kjo rrethanë faktike e ligjore përbën deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, parashikim i cili ka përcaktuar edhe vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
3. Arsyetimi im në vijim, për lehtësi leximi, është strukturuar të ndjekë konkluzionet e vendimit të shumicës për rrethanat të cilat, në vlerësimin tim, kanë përbërë bazë për të konkluduar në lënien në fuqi të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, për pasojë konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.
4. Lidhur me kontrollin e vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për disponimin e shumës prej 5.000.000 lekësh si gjendje *cash* në banesë që në vitin 2004 dhe verifikimin e burimeve të krijimit të kësaj shume, e cila ka shërbyer për financimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 126,5 m<sup>2</sup> në Vlorë, shumica ka arritur në konkluzionin si vijon.  
  
*Mbeti i paprovuar edhe përfitimi prej subjektit të rivlerësimit i shumës prej 2.000.000 lekësh, e deklaruar si vlerë e dhuruar prej motrës së subjektit dhe si burim për krijimin e shumës, vetëm në përgjigjet e saj për pyetësonin nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, shumë e cila nuk gjendej e specifikuar si në deklaratën e pasurisë “vetting”, ashtu edhe në deklaratën fillestare të pasurisë dhe as në përgjigjet e dhëna prej subjektit për pyetësonin standard nr. 1 të Komisionit, në të cilin ka dhënë shpjegime të detajuara për dhurimet e fituara prej motrës së saj, por sërish nuk përcakton këtë shumë. Mosshpjegimi dhe mospërcaktimi i kësaj të ardhure në këto deklarime pamundësoi kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së përfitimit të saj, e cila po ashtu ka shërbyer për të krijuar kursimet në “cash” të subjektit të rivlerësimit në vlerën prej 5.000.000 lekë.*
5. Nuk kam qenë dakord me shumicën për sa më sipër, e cila nuk e ka konsideruar shumën 2.000.000 lekë si pjesë të kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit, për disa arsye.

5.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ashtu siç është pranuar edhe nga shumica, ka deklaruar në mënyrë të detajuar burimet e krijimit të shumës 5.000.000 lekë, si vijon.

*Të ardhura neto në shumën 5.000.000 lekë, të përfituara nga: paga si studente e Shkollës së Magjistraturës (përfshi edhe vitin III të stazhit si gjyqtare), e kursyer e gjitha, plus punësimi si pedagoge në Universitetin jopublik {\*\*\*} që nga themelimi i tij në vitin 2003 (pa kontratë deri në vitin 2004), me pagë mujore 25.000 lekë, plus punësimi te biznesi i ndërtimit të motrës sime, znj. A. Ll. (Ç.), që nga viti IV i shkollës së mesme deri në vitin II të Shkollës së Magjistraturës (nuk kam pasur kontratë pune, për shkak se isha e punësuar në një biznes familjar), me pagë mujore 30.000 - 40.000 lekë, plus të ardhura të dhuruara nga motra ime znj. A. Ll. për shkak të mbarimit shkëlqyer të Shkollës së Magjistraturës. Gjatë kësaj kohe, të gjitha shpenzimet e mia përballoheshin nga të ardhurat nga bursa si studente e shkëlqyer nga Fakulteti i Drejtësisë, prindërit me të cilët banoja dhe motra, znj. A. Ll.*

Në këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit ka detajuar të ardhurat - elementet përbërëse të burimeve të krijimit të shumës në fjalë, por nuk ka evidentuar vlera për asnjë prej tyre. Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur edhe në deklaratën periodike të vitit 2004, në të cilën ka deklaruar: *Të holla "cash", të ruajtura në shtëpi. Burimi i krijimit: Nga kursimet mia dhe të familjes. Dhuratë nga motra ime. Vlera 5.000.000 lekë.*

Në parashtrimet dhe në konkluzionet përfundimtare, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se totali i të ardhurave të listuara si burim krijimi për shumën 5.000.000 lekë, ka qenë rreth 6.628.243 lekë. Nga këto të ardhura, subjekti ka kursyer shumën prej 5.000.000 lekësh.

Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se në një logjikë ekonomike dhe brenda kufijve të arsyes, ka qenë e pamundur për subjektin e rivlerësimit, që në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të arrinte të identifikonte se sa ka qenë vlera e saktë e kursyer nga secili prej këtyre burimeve të të ardhurave, nga të cilat së bashku, është arritur të kursethet shuma prej 5.000.000 lekësh, në kushtet kur këtë detajim nuk e kishte bërë as në deklaratën e afërt me kohën e krijimit të këtij kursimi, atë të vitit 2004. Për më tepër, vetë subjekti, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit në Komision dhe në Kolegj, shumën prej 2.000.000 lekësh e ka konsideruar, në mënyrë konsekuente, si të ardhur dhe jo si shumë totale të kursyer.

5.2 Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, është e vërtetë se subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje për shumën të dhuruara nga familjarët, pa përmendur vlerën e shumës së dhënë dhuratë të përmendur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por pakica vlerëson se subjekti nuk ishte në kushtet e detyrimit për të shpjeguar apo deklaruar këtë shumë, pasi pyetësi nr. 1 i Komisionit, i njohur edhe si pyetësi standard<sup>32</sup>, përmbante pyetje rreth fakteve dhe rrethanave të ndodhura në shtatë vitet e fundit nga momenti i fillimit të procesit të rivlerësimit, për periudhën 2010-2016, ndërsa dhurimi i shumës 2.000.000 lekë ka ndodhur në vitin 2004, kur ka mbaruar studimet në Shkollën e Magjistraturës.

---

<sup>32</sup> Pyetësi nr. 1, i njohur edhe si pyetësi standard, përmban pyetje të cilat janë të njëjta për të gjitha subjektet e rivlerësimit.

Dhurimi, në vetvete, si marrëdhënie nga e cila janë përfituar të ardhura që më pas kanë shërbyer si burim krijimi për kursimet në *cash*, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2004 dhe në atë të rivlerësimit, duke përmbushur kështu detyrimin që rrjedh nga kuadri ligjor për deklarimin e burimit të krijimit të kursimeve në *cash*, ndërsa specifikimi i vlerës së dhuruar është elaboruar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, kur i është kërkuar nga Komisioni se: *Nga hetimi administrativ, është konstatuar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, keni deklaruar kursime "cash" në vlerën 5.000.000 lekë. Ju lutemi të paraqisni dokumentacion provues ligjor për burimin/et e krijimit të kësaj shume, duke përcaktuar ato përkatësisht sipas viteve.*

Në ndryshim nga sa ka konkluduar shumica, vlerësova se përcaktimi i vlerës së dhurimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka pasur si qëllim evidentimin e vlerës së dhuruar, dhe jo nevojën për ndreqje të situatës financiare, pasi edhe nga pyetja e drejtuar nga Komisioni, e cila ka karakter të kërkimit të informacionit në lidhje me burimet e krijimit të shumës së deklaruar të kursyer, evidentohet qartë se Komisioni nuk ka konstatuar asnjë problematikë në këtë moment të procesit, të tillë që të shtynte subjektin e rivlerësimit në dhënien e vlerave jo të sakta dhe jo të vërteta. Do të ishte i dyshimtë deklarimi i vlerës së dhurimit prej 2.000.000 lekësh, nëse ky saktësim do të ishte bërë në fazën e shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, të cilat shënojnë momentin procedural të informimit të subjektit me rezultatin e pritshëm financiar, në varësi të të cilit lind dhe nevoja për të bërë korrektive apo ndryshime të qëndrimeve të mëparshme të tij. Në rastin konkret, subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, nuk i ka lindur kjo nevojë, pasi Komisioni, në asnjë moment të procesit të rivlerësimit, nuk i ka kaluar barrën e provës për shumën e dhuruar nga motra e saj me rastin e mbarimit me rezultate të shkëlqyera të Shkollës së Magjistraturës, madje as në rezultatet e hetimit administrativ nuk ka evidentuar problematika lidhur me këtë shumë të dhuruar.

**5.3** Sipas vlerësimit tim, kërkesa e shumicës së trupit gjykues për formalizimin e marrëdhënies së dhurimit, si dhe për dokumentacion provues si mandatpagesë apo transfertë bankare të kohës, shkon përtej asaj që ka elaboruar jurisprudenca e Kolegjit në raste të ngjashme. Në vlerësimin e pakicës, veprimi juridik i dhurimit të shumave monetare, nuk kërkon domosdoshmërisht formalizimin e vullnetit të palëve në një kontratë, pasi sipas përcaktimit të nenit 764 të Kodit Civil, formalizimi si kusht për vlefshmërinë e kontratës së dhurimit, kërkohet vetëm për dhurimin e sendeve të paluajtshme. Në këtë vlerësim, pakica mban në konsideratë dhe faktin se veprimi i dhurimit ka ndodhur mes subjekteve të lidhur nga marrëdhënie të posaçme e të ngushta familjare, si dhe në kohën kur znj. Lluri nuk kishte marrë ende cilësinë e zyrtarit deklarues pranë ILDKPKI-së, që të bënte të nevojshëm kujdesin e shtuar të saj apo të motrës së saj për të kryer dhurimin me transfertë bankare.

**5.4** Në rastin e shumave të dhuruara subjektit të rivlerësimit, neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 potencon detyrimin e subjektit të rivlerësimit dhe të personit tjetër të lidhur për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhuruar. Edhe udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, nën të njëjtën frymë, ka kërkuar që *nëse subjekti i rivlerësimit deklaron marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur,*

referuar burimit të krijimit, të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë subjektit të rivlerësimit.

Në rastin konkret, mundësia e krijimit të shumës prej 2.000.000 lekësh me burime të ligjshme nga znj. A. e z. A. Ç., të cilët kanë konfirmuar dhurimin në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.06.2018, është hetuar dhe konfirmuar nga Komisioni dhe është pranuar pa asnjë dyshim nga Komisioneri Publik dhe shumica në vendim, se plotëson kushtet e ligjshmërisë sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky fakt, të cilit i është dhënë rëndësi e posaçme nga kuadri ligjor, është vlerësuar prej meje me peshë bindëse për besueshmërinë e ekzistencës së dhurimit, si dhe vlerën e tij.

6. Në konkluzion, në vijim të arsyetimit si më sipër, vlerësova se deklarimi nga subjekti i rivlerësimit i dhurimit si e ardhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2004, në përmbushje të detyrimit ligjor për të listuar burimet e krijimit të kursimeve në *cash*, si dhe justifikimi *bindshëm* i mundësisë financiare të dhuruesve për të realizuar dhurimin, dalin në pah në kontrast me faktin se vlera e shumës së dhuruar është deklaruar vetëm në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit. Në këto këto kushte, pakica vlerësoi se deklarimi i dhurimit në shumën 2.000.000 lekë, si një nga burimet e ligjshme të krijimit të kursimeve në *cash*, në shumën 5.000.000 lekë, është një deklaram i saktë dhe i vërtetë.
7. Lidhur me të ardhurat e deklaruara prej subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit si të përfituara në vitet 1997-2004 nga punësimi te biznesi i motrës, shumica ka arritur në përfundimin se mbetën në nivel deklarativ e të paprovuar, si marrëdhënia e dekluar e punësimit të subjektit te biznesi i motrës së saj, ashtu edhe të ardhurat e krijuara nga kjo marrëdhënie në vitet 1997-2004, në vlerën prej 3.360.000 lekësh.
8. Votova kundër shumicës edhe për këtë aspekt të shkaqeve të ankimit dhe procesit të rivlerësimit të subjektit.

Për një kontekst të plotë të rrethanave faktike, sjell në vëmendje si vijon.

**8.1** Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti, në renditjen e burimeve të krijimit të kursimit prej 5.000.000 lekësh, ndër të tjera, ka deklaruar: *Të ardhura të përfituara nga punësimi te biznesi i ndërtimit të motrës sime, znj. A. Ll. (Ç.), që nga viti IV i shkollës së mesme deri në vitin II të Shkollës së Magjistraturës (nuk kam pasur kontratë pune, për shkak se isha e punësuar në një biznes familjar), me pagë mujore 30.000 - 40.000 lekë [...].*

**8.2** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni<sup>33</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Pjesa tjetër e shumës prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh përbëhet nga kursimet e mia të përfituara nga motra ime, znj. A. Ç., dhe bashkëshorti i saj, z. A. Ç. Kjo shumë përbëhet nga pagesat mujore që motra dhe bashkëshorti i saj më kanë dhënë nga viti i IV i shkollës së mesme deri në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës për periudhën 1997-2004, në shumën 35.000*

---

<sup>33</sup> Në përgjigje të pyetjes së drejtuar nga Komisioni: “Nga hetimi administrativ, është konstatuar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, keni deklaruar kursime “cash” në vlerën 5.000.000 lekë. Ju lutemi të paraqisni dokumentacion provues ligjor për burimin/et e krijimit të kësaj shume, duke i përcaktuar ato përkatësisht sipas viteve”.

*(tridhjetë e pesë mijë) lekë/muaj, për shkak të ndihmesës që kam dhënë në biznesin familjar të qiradhënies. Në total, kjo shumë, për periudhën 8-vjeçare, 1997-2004, e barabartë me 96 muaj, është 35.000 lekë/muaj x 96 muaj = 3.360.000 (tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Me familjarët e mi, nuk kam pasur një kontratë pune për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta familjare dhe këto shuma janë përfituar si shpërblim mujor, dhënë prej tyre. Gjatë gjithë periudhës së sipërcituar, shpenzimet e mia për jetesë janë përballuar nga të ardhurat e familjarëve të mi e, për sa më sipër, shumat e sipërcituara janë kursime të miat ndër vite, të përfituara përpara se sa unë të filloja ushtrimin e detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Një fakt i tillë provohet me anë të deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., dt. 25.06.2018, hartuar nga motra ime A. Ll. (Ç.) dhe bashkëshorti i saj A. Ç. përpara noteres M. Ll., me anë të së cilës shtetasit e sipërcituar deklarojnë dhënien e këtyre pagesave në favorin tim, për periudhën 1997-2004.*

**8.3** Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se: *[...] kam pasur ndihmë dhe kontribut nga motra ime A. Ç., duke më dhënë çdo muaj një shumë të hollash në vlerën 35.000 lekë. Kjo ndihmë nuk ishte në formën e pagës mujore, sepse unë nuk punoja e nuk mund të isha e punësuar në atë periudhë, por për të mos u ndërjer unë keq e për të më shpërblyer në njëfarë mënyre lidhur me ndihmën që unë i jepja motrës sime në mbajtjen e fëmijëve (5 dhe 7 vjeç në atë kohë), në mbledhjen e qirave të pasurive të paluajtshme të tyre dhe për çdo nevojë e mundësi që unë kisha për t'i ndihmuar. Më lejoni t'i bëj me dije këtij komisioni se gjatë gjithë periudhës së fëmijërisë dhe adoleshencës e rinisë sime të hershme, motra ime dhe bashkëshorti i saj më kanë trajtuar si të më kishin fëmijën e tyre, duke u përgjigjur për të gjitha kërkesat e nevojat që kisha për të vazhduar studimet e mesme e të larta. Ka qenë pikërisht kjo marrëdhënie kaq e ngushtë afektive që unë kam pasur me motrën time, arsyeja që ata më kanë ndihmuar me të gjitha shumat e deklaruara nga ana ime në deklaratat periodike vjetore dhe në shpjegimet në përgjigjet e pyetësorëve. Fondet që motra dhe bashkëshorti i saj më akordonin mua, ishin të ardhura të ligjshme, të realizuara nga qiratë e pasurive të paluajtshme që ata dispononin e për të cilat, në çdo rast, kanë paguar tatimin në burim mbi të ardhurat e realizuara. Siç e shpjegova më lart, në asnjë rast, unë nuk kam qenë në një marrëdhënie punësimi, që të isha e siguruar apo të paguaja tatim mbi të ardhurat, për sa kohë që për këto shuma të dhëna në çdo muaj, motra dhe bashkëshorti i saj kanë paguar tatimin mbi të ardhurat nga qiratë.*

**8.4** Në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.6.2018, z. A. dhe znj. A. Ç., deklarojnë se znj. Elbana Lluri ka qenë e punësuar pranë biznesit të tyre të ndërtimit dhe qiradhënies me pagë mujore 35.000 lekë në muaj; ndërsa në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.12.2020, ata kanë deklaruar se znj. Lluri, gjatë periudhës 1997-2004, shuma prej 35.000 lekësh në muaj i është dhënë asaj, në formën e një shpërblimi simbolik mujor, për shkak të ndihmës së dhënë në rritjen e fëmijëve të tyre, si dhe në mbledhjen e qirave të pasurive të paluajtshme që kanë pasur në pronësi, por në asnjë rast ajo nuk ka qenë e punësuar pranë shoqërisë që ata kanë në pronësi.

**8.5** Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka pohuar gjyqësisht se: *kam theksuar se kjo e ardhur nuk ka qenë si rezultat i një marrëdhënieje punësimi sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Për shkak të ndihmesës që i kam dhënë motrës në mënyrë të vazhdueshme në biznesin e saj*

*që lidhet edhe me marrëdhëniet e afërta që unë kam pasur dhe kam me të, duke qenë se ajo ka pasur mundësi të mira ekonomike, më ka dhënë një shpërblim në fund të muajit. Unë kurrë nuk e kam konsideruar një marrëdhënie të mirëfilltë pune dhe kjo ka qenë arsyeja që në deklaratën para fillimit të detyrës, këto shuma i kam konsideruar “dhuratë nga motra”, pra nga ana ime kjo shumë është konsideruar dhuratë, dhe deklaratimet e motrës sime se unë kam punuar pranë biznesit të saj familjar, duhen konsideruar si motivi që e ka shtyrë atë për të më dhënë një shumë simbolike, sipas saj.*

9. Në kundërshtim me sa ka arsyetuar shumica, vlerësova se edhe nga një analizë kritike e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, të pasqyruara si më sipër, të cilat përbëjnë provë në këtë proces, bazuar në nenin 49, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezulton se ajo nuk ka pranuar asnjëherë se marrëdhënia e saj me biznesin e familjarëve të saj ka qenë një marrëdhënie punësimi e mirëfilltë. Ajo ka deklaruar, duke filluar që nga deklaratat e pasurisë së rivlerësimit, se kjo marrëdhënie nuk ka qenë e formalizuar dhe këtë qëndrim e ka vijuar edhe në shpjegimet e mëvonshme në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj. Do të ishte naiv prezumimi se subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, në plotësimin e deklaratës së rivlerësimit, nuk ka qenë e ndërgjegjshme për konsekuencat që sillte deklarimi se marrëdhënia e punësimit nuk ka qenë e formalizuar, në raport me parashikimin kushtetues të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, se pasuri të ligjshme konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Për këtë arsye, në vlerësimin tim, deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit, se ka qenë në marrëdhënie pune në biznesin e së motrës, ka pasur si qëllim theksimin e periodicitetit të përfitimit të shpërblimit të dhënë nga familjarët e saj, për një punë/ndihmë të dhënë prej saj, të shtrirë gjatë në kohë.
10. Edhe natyra e “veprimtarisë” së kryer nga subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, siç është përshkruar prej saj në shpjegimet e dhëna në Komision dhe në Kolegj dhe siç është shpjeguar edhe nga bashkëshortët Ç., si ndihmë e dhënë në rritjen e fëmijëve të tyre, si dhe në mbledhjen e qirave të pasurive të paluajtshme që kanë pasur në pronësi, si dhe kryerja e saj nga subjekti i rivlerësimit në kohën që ndiqte studimet e mesme dhe të larta, ka qenë e tillë që përputhet me konceptin e një ndihmese të dhënë prej saj dhe jo me një marrëdhënie pune të mirëfilltë, me tërësinë e elementeve të saj.
11. Edhe deklaratimet para noterit publik të bashkëshortëve Ç., i kam vlerësuar si deklarime në vijimësi dhe plotësim të njëri-tjetrit, për të sqaruar kuptimin që ata i kanë dhënë termit “punësim” dhe për të shpjeguar se ku ka konsistuar “puna” e bërë nga subjekti i rivlerësimit.
12. Marrëdhënia e ngushtë familjare që ka ekzistuar mes subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të ngushtë të saj dhe ndihma që ata i kanë dhënë subjektit të rivlerësimit, qoftë kjo edhe në formën e një shpërblimi, është konsideruar e besueshme nga pakica, pasi kjo ndihmë e dhënë nga motra e saj ka qenë e vazhdueshme, në shërbim të jetesës më të mirë për prindërit e saj dhe subjektin e rivlerësimit gjatë ndjekjes së studimeve, por edhe në kohën që ajo ka qenë në marrëdhënie pune si



gjqtare<sup>34</sup>. Dhënia e kësaj ndihme, apo shpërblimi, bëhet e besueshme, sidomos për faktin se të ardhurat e familjarëve të subjektit të rivlerësimit kalojnë testin e kërkuar nga ligji, pasi është evidentuar se kanë pasur në dispozicion burime financiare të ligjshme të mjaftueshme, madje të konsiderueshme, për të justifikuar ndihmën e dhënë subjektit të rivlerësimit gjatë jetës së saj.

13. Në një vlerësim objektiv dhe harmonik të rrethanave specifike të rastit, duke marrë në konsideratë elementet, si: shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, periudhën prej 7 vitesh të shtrirjes në kohë të dhënies së shpërblimit/ndihmës nga familjarët e subjektit të rivlerësimit, kohën e dhënies së kësaj ndihme që përkon me një periudhë kur subjekti ka qenë në ndjekje të studimeve, peshën ekonomike të papërfillshme të vlerës së kësaj ndihme në raport me të ardhurat e familjarëve të subjektit të rivlerësimit, krijova bindjen se ndihma e përfituar nga të afërmit ka shërbyer si burim krijimi për kursimet në *cash*, të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe asaj të vitit 2004.
14. Në konkluzion, unë, gjyqtarja në pakicë vlerësova se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që me burime të ligjshme të krijonte kursimet në *cash*, në shumën 5.000.000 lekë, të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe atë të vitit 2004, kursime të cilat janë shtuar e pakësuar në vitet vijuese, si rezultat i kursimeve në *cash* me burim nga pagat dhe kryerjes së shpenzimeve të deklaruara duke përdorur këto kursime, për të qenë të disponueshme për të shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament në Vlorë, në vitin 2016.
15. Shumica, në funksion të verifikimit dhe kontrollit të kursimeve në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë për vitet 2006-2012, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit deri në fund të vitit 2012, kishte mundësi të justifikonte krijimin e kursimeve në vlerën prej 1.789.239 lekësh.

Unë, gjyqtarja në pakicë, kursimet e subjektit të rivlerësimit, të akumuluar për periudhën 2006-2012, i kam përlllogaritur në shumën 1.824.132 lekë, duke konstatuar se diferenca nga vlera e përlllogaritur nga shumica, vjen si pasojë e shpërndarjes së ndryshme matematikore të shumës totale të të ardhurave të përfituara nga subjekti nga Universiteti jopublik {\*\*\*}, për periudhën janar 2006 - dhjetor 2008. Shumica ka kryer shpërndarjen e të ardhurave duke përdorur si bazë kohëzgjatjen e vitit akademik prej 9 muajsh, ndërsa unë, gjyqtarja në pakicë, kam përdorur si bazë shpërndarjeje vitin kalendarik prej 12 muajsh, referuar vërtetimit të datës 26.10.2016 dhe vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 16.12.2019, të lëshuar nga Universiteti jopublik {\*\*\*}, i cili pasqyron të dhëna për periudhën nga janari në dhjetor, si dhe faktin e njohur se përfshirja e pedagogëve në vitin akademik universitar është më e gjatë për shkak të angazhimit të tyre në sezonet e provimeve.

Si rrjedhojë e arsyetimit si më sipër, vlerësova se shumica e kursimeve në *cash* të akumuluar, të krijuara nga burime të ligjshme, të disponuara nga subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2012, ishte në shumën 5.824.132 lekë [duke përfshirë shumën prej 5.000.000 lekësh, sipas konkluzioneve të arritura në paragrafët 4 - 14 më sipër].

---

<sup>34</sup> Në vitin 2011, bashkëshortët Ç. i kanë dhuruar subjektit të rivlerësimit 1/2 pjesë të pasurisë apartament me sipërfaqe 125 m<sup>2</sup> në Tiranë.

16. Si gjyqtare në pakicë, nuk rashë dakord as me vlerësimin e shumicës mbi kursimet në *cash* të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, ish-bashkëshortit të saj, duke votuar kundër, për arsyet në vijim.  
Sipas shumicës së trupit gjykues, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, në fund të vitit 2004, ka pasur në disponim si kursim në *cash* vlerën 218.204 lekë, si rezultat i diferencës 1.218.204 lekë, *cash* në dispozicion në vitin 2003 – 1.000.000 lekë, vlera e automjetit të blerë në vitin 2004.
17. Kundërshtova këtë vlerësim të shumicës, pasi çmoj se gjendja e kursimeve të ligjshme në *cash* të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në fund të vitit 2004, ka qenë në shumën prej 713.820 lekësh. Ky vlerësim i ndryshëm vjen për shkak të analizimit në një optikë objektive të deklarimit të personit të lidhur në deklaratën periodike të interesave të vitit 2004.  
Në këtë deklaratë, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura vjetore nga paga si student në Shkollën e Magjistraturës dhe nga puna në sektorin privat, kursime personale të miat që nga viti 1995 e në vazhdim deri sot, në shumën 1.500.000 lekë në të holla “cash” në shtëpi.*  
Në interpretim të deklarimit si më sipër të subjektit të rivlerësimit, pakica konstatoi se në raport me kursimet e krijuara nga burimet të ligjshme në shumën 1.218.204 lekë, të disponueshme në fillim të vitit 2004, gjendja e kursimeve në *cash* të personit të lidhur është pakësuar me 1.147.766 lekë<sup>35</sup>, për shkak të blerjes së automjetit tip “Mercedes Benz”, në datë 01.11.2004, për të cilin si burim krijimi janë deklaruar kursimet personale<sup>36</sup>. Për pasojë, pas blerjes së automjetit, personi i lidhur kishte gjendje *cash*, të krijuar nga burime të ligjshme, shumën 70.438 lekë, e cila rrjedh nga diferenca mes gjendjes së kursimeve në *cash* në fillim të vitit 2004, dhe vlerës së blerjes së automjetit. Në burimet e krijimit të kursimeve në *cash*, personi i lidhur, duke deklaruar *kursime që nga viti 1995 e në vazhdim deri sot*, ka përfshirë edhe kursimet e krijuara nga të ardhurat gjatë vitit 2004. Në një interpretim të arsyeshëm dhe objektiv të këtij deklarimi të subjektit të rivlerësimit, pakica çmoi se gjendja e kursimeve në *cash* në fund të vitit 2004, është produkt kumualtiv i kursimeve të ligjshme të mbetura nga viti 2003, në shumën 70.438 lekë, dhe mundësisë së kursimit të subjektit gjatë vitit 2004, në shumën 643.382 lekë, e rezultuar si diferencë mes të ardhurave të përfituara dhe shpenzimeve të kryera gjatë këtij viti. Si rezultat, gjendja e kursimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, në fund të vitit 2004, në *cash*, çmohet të jetë në shumën prej 713.820 lekësh.
18. Për sa u përket kursimeve në *cash* të personit të lidhur për vitin 2006, pakica vëren se shumica e trupit gjykues ka konsideruar si kursim për personin e lidhur shumën prej 468.114 lekësh. Nga përllogaritjet e kryera nga gjyqtarët në pakicë, rezulton se kursimet në *cash* të personit të lidhur për këtë vit, duhet të konsideroheshin në shumën 495.200 lekë. Kjo luhet në vlera vjen si rezultat i shpërndarjes së ndryshme të vlerës totale të të ardhurave të përfituara nga z. H. nga Universiteti jopublik {\*\*\*}, duke përdorur të njëjtin arsyetim si më sipër, në paragrafin 15.

<sup>35</sup> E përllogaritur sipas kursit të këmbimit 1 euro = 126,74 lekë, të Bankës së Shqipërisë, në datën e blerjes së pasurisë.

<sup>36</sup> Në rubrikën “Pasuri të paluajtshme e të luajtshme”, në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Autoveturë benz, viti i prodhimit 1998, ngjyrë gri, me targa {\*\*\*}. Blerë nga kursimet personale në datë 01.11.2004. Vlera 5.900 euro, plus 400.000 lekë zhdoganim, taksë regjistrimi dhe taksë pasurie”.

19. Shumica ka arritur në konkluzionin se të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit në pronësi të personit të lidhur, në vlerën prej 1.200.000 lekësh, nuk konsiderohen si kursim i krijuar në vitin kalendarik 2011 dhe, për pasojë, kjo shumë nuk përfshihet në volumin e kursimeve *cash* që janë përdorur sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në blerjen e pasurisë apartament në Vlorë, në vitin 2016.
20. Vlerësova ndryshe nga shumica lidhur me sa më sipër, në përgjigje të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, si dhe në vijim edhe të qëndrimeve të mbajtura tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit<sup>37</sup>, e konkretisht:

20.1 Shuma prej 1.200.000 lekësh ka rrjedhur nga një transaksion i ligjshëm - shitja e automjetit tip “Daimler Chrysler”, veprim juridik ky lehtësisht i verifikueshëm nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, për rrjedhojë rezulton të jetë krijuar nga burime të ligjshme.

20.2 Subjekti i rivlerësimit, çmimin e shitjes së makinës e ka përfituar në dy këste: më datë 31.03.2011, në shumën 1.000.000 lekë dhe më datë 29.10.2011, në shumën 200.000 lekë. Nga leximi i kryqëzuar i të dhënave të kontratës së shitblerjes së automjetit, të dhënave zyrtare të përcjella në Komision nga DPSHTRr, si dhe deklaratës noteriale të z. E. G., blerësit të automjetit, rezulton se ky i fundit e ka marrë automjetin në dorëzim në datën e lidhjes së kontratës së shitjes dhe makina i është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në po të njëjtën datë, në gjendje të rregullt teknike. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit e kishte ende në pronësi dhe në përdorim automjetin edhe pas përfitimit të pagesës së parë pas premtimit të shitjes së tij, duket e logjikshme që vlerën e përfituar prej 1.000.000 lekësh të mos ta shpenzonte, pasi nuk kishte siguri për lidhjen e kontratës së shitjes, por edhe për faktin se kishte detyrimin që në momentin e shitjes së premtuar, mjetin ta dorëzonte te blerësi në gjendje të rregullt teknike. Në këtë kuptim, është e pranueshme dhe e besueshme që, në datën 29.10.2011, datë e lidhjes së kontratës së shitjes së automjetit, subjekti i rivlerësimit të posedonte vlerën e plotë të shitjes së automjetit, prej 1.200.000 lekësh, në *cash*.

20.3 Koha relativisht e shkurtër nga momenti i përfitimit të plotë të vlerës së shitjes së automjetit në datën 29.10.2011, deri në datën 31.12.2011, datë në të cilën verifikohet e deklarohet gjendja e kursimeve në *cash*, nuk ndikon për të ngritur një dyshim të arsyeshëm te trupi gjykues në drejtim të shpenzimit tërësisht të kësaj shume, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në harkun kohor mars - dhjetor 2011, nuk ka krijuar pasuri. Shlyerja e pagesës për këstin e parë të apartamentit me sipërfaqe 125 m<sup>2</sup> në Tiranë, më datë 10.02.2011, rreth dy muaj para lidhjes së kontratës premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.03.2011, për automjetin tip “Daimler Chrysler”, përjashton logjikisht mundësinë e përdorimit të shumës së përfituar nga shitja e automjetit si burim për këtë pagesë, mbështetur edhe në faktin se sipas përcaktimit kontraktor, shuma prej 1.000.000 lekësh është përfituar nga subjekti i rivlerësimit në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

---

<sup>37</sup> Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021, paragrafi 44; vendimi nr. 37/2021 (JR), datë 24.11.2021, paragrafi 10.25; vendimi nr. 20/2022, datë 14.06.2022, paragrafi 14.

**20.4** Nga verifikimi i dokumentacionit të krijuar gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që të tregojë se shuma e përfituar nga shitja e automjetit të jetë përdorur në ndonjë destinacion tjetër, në drejtim të krijimit të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, apo për kryerjen e shpenzimeve të tjera.

**20.5** Përdorimi i këtyre të ardhurave për financimin e blerjes së pasurisë automjet “Citroen C4”, është kryer në distancë të afërt kohore nga data 29.10.2011, datë e përfitimit të plotë të shumës prej 1.200.000 lekësh, deri në datën e lidhjes së kontratës së qirasë financiare-*leasing* nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.08.2012, sipas së cilës pagesa e një pjese të çmimit të automjetit është likuiduar në datën e nënshkrimit të saj.

**20.6** Deklarimi i të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit e më tej përdorimi i tyre si burim krijimi për pasuritë e tjera, nuk është një deklaram i posaçëm i kryer nga subjekti i rivlerësimit vetëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por ka qenë një deklaram i bërë që në deklaratat periodike të interesave të viteve 2011 e 2012.

- 21.** Argumenti i përdorur nga shumica se kjo shumë mund të ketë suportuar transaksionet e rëndësishme financiare të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjatë këtij viti, në vlerësimin e pakicës, përbën alogjizëm, pasi vjen në kundërshtim me sa ka arsyetuar vetë shumica në lidhje me burimet e krijimit të pasurive të personit të lidhur, si dhe nuk përputhet në kohë me kryerjen e transaksioneve të pretenduara dhe disponimin e të ardhurave nga shitja e automjetit prej personit të lidhur. Konkretisht, pagesa e këstit të apartamentit në Tiranë është kryer nga personi i lidhur më datë 10.02.2011, më parë nga data e lidhjes së kontratës premtim shitje të automjetit, e cila daton më 31.03.2011. Për më tepër, vetë shumica ka pranuar në paragrafin 22.15 të vendimit, se *duke llogaritur të gjitha kursimet e personit të lidhur të deklaruar si të tilla, deri në vitin 2010, rezulton se ai dispononte në fund të këtij viti shumën prej 2.086.318 lekësh*, përfundim i cili orienton pakicën në konkluzionin se personi i lidhur nuk kishte nevojë të përdorte të ardhura të tjera të krijuara gjatë vitit 2011.

Kredia në Bankën Emporiki, në vlerën prej 25.000 eurosh, më datë 02.02.2011, nga subjekti i rivlerësimit është shlyer me anë të huas së marrë prindërve të saj në të njëjtën vlerë, duke bërë të panevojshme përdorimin e të ardhurave të përfituara nga z. H. nga shitja e automjetit, edhe në prezumimin se këto të ardhura disponoheshin nga z. H., edhe pse ky është prezumimi më i disfavorshëm në raport me rrethanat faktike të kohës së shitjes së kësaj pasurie dhe në raport me faktin se subjekti i rivlerësimit dhe z. H. kanë pranuar se kanë filluar bashkëjetesën në muajin maj të vitit 2011.

Në të njëjtën mënyrë, arsyetova edhe mbi argumentin e shumicës se kjo shumë mund të jetë përdorur nga babai i personit të lidhur për blerjen e automjetit tip “Audi Q7” në korrik të vitit 2011, duke e gjetur këtë konkluzion si një supozim të pambështetur në prova dhe shpjegimet e dhëna nga z. H., gjatë procesit të tij të rivlerësimit, se ka filluar bashkëjetesën me znj. Lluri në maj të vitit 2011, pra në kohën e disponimit të vlerës së plotë nga shitja e automjetit, personi i lidhur nuk jetonte me familjen e origjinës.

- 22.** Në përfundim të këtij arsytimi, si gjyqtare në pakicë, konstatova se shuma kumulative e kursimeve në *cash*, që personi i lidhur dispononte nga burime të ligjshme, në fund të vitit 2011,

ishte në vlerën 2.309.020 lekë. Bazuar në deklaratimet e personit të lidhur në deklaratën periodike të interesave të vitit 2012, mbi shtesat dhe pakësimet e kursimeve në *cash*, shuma e sipërcituar rezulton të ketë evoluar në vlerën 1.629.492 lekë, për shkak të pakësimit nga blerja e automjetit tip “Citroen C4”, shumë e cila iu përfshi në totalin e kursimeve *cash* që janë përdorur sipas deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në blerjen e pasurisë apartament në Vlorë, në vitin 2016.

23. Si rrjedhojë e konstatimeve si më sipër, mbi vlerat e kursimeve në *cash* të analizuara për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të, pakica vlerësoi se shuma e kursimeve në *cash* të akumuluar, të disponuara prej tyre në fillim të vitit 2016, ishte në shumën 6.953.624 lekë. Kjo vlerë e kursimeve në *cash*, u përdor në kryerjen e analizës financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur që, me burime të ligjshme, të kryenin pagesën e pasurisë apartament me sipërfaqe 126,5 m<sup>2</sup> në Vlorë, më datë 09.09.2016, në vlerën 7.615.223 lekë. Nga analiza financiare, rezultoi një balancë negative prej 957.274 lekësh, e cila vjen si pasojë e analizës dhe shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, duke përfshirë këtu edhe konkluzionet e shumicës, për të cilat është ndarë i njëjti qëndrim.
24. Në konsideratë të këtij arsytimi, si gjyqtare në pakicë, kam vlerësuar se kjo mungesë e burimeve financiare, e konstatuar vetëm për vitin 2016 për subjektin e rivlerësimit, nuk mund të shërbejë si e vetmja arsye mbi të cilën të bazohet vendosja e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
25. Duke e konsideruar këtë shkelje në bazë të autoritetit diskrecional të gjykatës për zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit e kalon testin e standardit kushtetues të provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjithashtu gjendet edhe në kushtet e parashikuara edhe nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.
26. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” dhe një nivel kualifikues në kriterin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, pakica arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit dhe, për pasojë, duhet të konfirmohet në detyrë, në zbatim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke u lënë në fuqi vendimi nr. 342, datë 02.02.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili e ka konfirmuar atë në detyrë.

**GJYQTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*